

1 E hënë, 19 gusht 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar
13 Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
15 -- mirë. Fillimisht mirëmëngjesi të gjithëve, mirë se u kthyet
16 në sallën e gjyqit.

17 Përpara se të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
18 Prokurorisë 04868, kemi katër urdhra me gojë dhe disa
19 direktiva dhe udhëzime që duhet thënë për procesverbal.

20 Trupi Gjykses do t'ju japi palëve dhe po ashtu mundësinë
21 të japin mendimet e tyre siç është kërkuar nga Mbrojtja e
22 Veselit.

23 Sa i takon urdhrin të parë me gojë, që ta keni parasysh,
24 kam një natyrë teknike kryesisht.

25 Urdhri i parë me gojë, Trupi Gjykses rikujton se prova

1 materiale me numër P01444 është pranuar përmes Dëshmitarit
2 04501. E njëjta fotografi ka marrë një numër për identifikim
3 të përkohshëm me numrin P01283. Njësia për Administrimin e
4 Gjykatës sugjeron që ky numër prove materiale të marri numrin
5 për identifikim të përkohshëm që i është caktuar dhe
6 fotografisë. Dhe gjithashtu të bëhet përditësimi përkatës në
7 *Legal Workflow*, përkatësisht të hiqet numri P01444 dhe të
8 vendoset numri që vendosa pak më herët.

9 Keni kundërshtime?

10 PËRKTHYESJA: Palët nuk kanë kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

12 Meqë nuk ka kundërshtime nga palët, Trupi Gjykses udhëzon
13 Sekretaren e Gjykatës që numrit P01832, përndryshe
14 SPOE00117408-00117408 t'i bëjë përditësimin përkatës. E më
15 gjegjësisht, ju lutem hiqni numrin P01444.

16 Urdhri i dytë me gojë.

17 ZPS-ja ka kërkuar të bëhet një zëvendësim i dokumentit që
18 është pranuar me numrin 1D00666-ET dhe t'i vendoset një numër,
19 t'i vendoset një version i rishikuar. Ky dokument, pra, është
20 nxjerrë përmes paketës së materialeve 997, e më konkretisht
21 thjesht ka disa rishikime të vogla.

22 Pjesa 2 e dokumentit thotë, që:

23 "Çelësat duhet të dorëzohen brenda një dite. Përndryshe,
24 zyrat do të dëmtohen, pra, do të mbyllen dhe personat
25 përgjegjës duhet t'i japim shpjegimet ushtrisë."

1 Ky ka qenë përkthimi i parë.

2 ZPS-ja ka bërë një përkthim tjetër dhe thotë:

3 "Afati për të dorëzuar çelësat është një ditë.

4 Përndryshe, ambienti do të dëmtohet, pra, do të prishet edhe
5 personat përgjegjës do të duhet të japin llogaritë përkatëse."

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Na jepni kohë ta rishikojmë, ju
7 lutem, në mënyrë që të bëjmë komentet përkatëse pas pushimit
8 të parë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër. Të
10 gjithë do të keni mundësinë që t'i rishikoni dhe të jepni
11 komentet përkatëse.

12 Urdhri i tretë me gojë, më 5 qershor 2024, ZPS-ja nxori
13 versionin e redaktuar të dokumenteve që janë pranuar si prova
14 materiale. Nëse nuk ka kundërshtime, versionet e redaktuara do
15 të lidhen me provat materiale përkatëse dhe me numrat e tyre.

16 Keni kundërshtime?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Nuk ka kundërshtime. Trupi Gjykues urdhëron Sekretaren e
20 Gjykatës që të lidhë materialin 5014328 deri në 4014329 RED me
21 materialin përkatës. Si dhe materialin P007784, P0077893 RED
22 me provën materiale, përkatësisht 1D00156 dhe 1D00157.

23 Ka ndonjë kundërshtim? Kush po fliste? U dëgjua diçka në
24 mikrofon. Kishte një mbivendosje zërash? Në rregull. Po duhet
25 zgjidhur, duhet zgjidhur problemi sepse kemi një zë që

1 përsëritet. Ka një problem teknik.

2 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
3 këshillohen]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Krasniqi,
5 jeni gati të vazhdojmë?

6 I AKUZUARI KRASNIQI: [Përmes videolidhjes] [Nuk ka
7 përkthim].

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] U kuptuam, z.
9 Krasniqi. Do presim pak. A mund të thoni diçka z. Krasniqi që
10 të kuptojmë nëse po e merrni përkthimin? Mund të flisni? Z.
11 Krasniqi, mund të flisni? Na dëgjoni? Na dëgjoni në shqip, z.
12 Krasniqi? Z. Krasniqi, tani e merrni përkthimin, e dëgjoni
13 përkthimin?

14 I AKUZUARI KRASNIQI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Okej. Ju
16 kërkujmë ndjesë atëherë. Bëjmë një pushim të shkurtër në
17 mënyrë që të zgjidhim problemin teknik dhe pastaj të vazhdomë
18 me urdhrin tjetër me gojë.

19 I AKUZUARI KRASNIQI: [Përmes videolidhjes] E tash po e
20 ndëgjoj.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 9.08

22 --- Seanca rifillon në orën 9.12

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'e mbarova
24 në fakt urdhrin e tretë me gojë, do të përsëris edhe një herë.

25 Urdhëron Trupi Gjykses Sekretaren e Gjykatës që dokumenti

1 me numër P014328-5014329 RED dhe dokumentin P007784-P00793 RED
2 t'i lidhë me provat materiale 1D00156 dhe 1D00157, sipas
3 radhës përkatëse.

4 Gjithashtu, më 12 korrik 2024, ZPS-ja kërkoi që të
5 zëvendësohej një përkthim i anglishtes i transkriptit që ishte
6 pranuar me numrin P01327.8 dhe bëhej një përkthim i
7 përditësuar i kësaj pjese.

8 Keni ndonjë kundërshtim?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
11 tjetër? Nga ana e Prokurorisë?

12 Atëherë kundërshtime nuk ka. Trupi Gjykses urdhëron
13 Sekretaren e Gjykatës që dokumentin me numër 083249-TR-ET
14 Pjesa 8 Revised ta zëvendësojë me dokumentin që tashmë ka
15 numrin 083249-TR-ET Pjesa 8 Revised ET.

16 Trupi Gjykses është njoftuar që Mbrojtja e Veselit ka
17 kërkuar që të bëjë një parashtrim lidhur me aspektet që lidhen
18 me rregullën 107.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit.

20 Të enjten e shkuar morëm materialet e seancës përgatitore
21 dhe radhën e dëshmitarëve që do të japin dëshmi në një email.
22 Në email thuhej që dëshmitari kishte me vete materiale që nuk
23 mund t'i jepeshin Prokurorisë edhe rrjedhimisht as Mbrojtjes,
24 por sidoqoftë do të përdoreshin nga dëshmitari për t'i
25 rifreskuar kujtesën gjatë seancës përgatitore. Sidoqoftë nuk

1 është bërë e qartë kur në ç'moment përmenden këto materiale.

2 Të premtën ne ju kërkuam të evidentojnë paragrafët
3 përkatës që lidhen me këto materiale dhe të na sqarojnë çfarë
4 hapash duhet të ndërmarim për t'i parë këto materiale.

5 Prokuroria na tha që kishin pyetur dëshmitarin lidhur me
6 këto materiale por nuk ishin të sigurt nëse mund t'i merrnim
7 materialet para se të jepet dëshminë dëshmitari. Dhe
8 gjithashtu na thanë që ai u është referuar këtyre materialeve
9 në tre pika konkrete.

10 Tani, ne nuk e kemi të qartë a i ka përdorur këto
11 materiale gjatë gjithë seancës përgatitore dëshmitari dhe ne
12 duam të dimë se kur mund t'i marrim dhe ne këto materiale dhe
13 gjithashtu çfarë janë këto materiale. Ne e kuptojmë që nuk
14 mund të na thonë në hollësi, po të dimë vëllimin së paku dhe
15 Prokuroria natyre kanë këto materiale, sepse këto mbase mund
16 t'i përdorim për kundërpjetet tona dhe nuk është normale që
17 në momentin e fundit të na thonë që dëshmitari do të përdorë
18 disa materiale që ne nuk mund t'i shohim, na vendosni në një
19 situatë të vështirë.

20 Ky është një dëshmitar që ka qenë objekt i një kërkesë
21 për ndryshimin e aktakuzës në një moment të mëvonshëm gjatë
22 fazës paraprake dhe është një dëshmitar që nuk ka folur një
23 herë po ka folur dy herë. Dhe është e padrejtë që vjen tani
24 dëshmitari në Hagë me dokumente të reja. Dhe na vendos në një
25 pozicion kaq të vështirë.

1 Pra, ne duam të kuptojmë fillimisht nga Prokuroria, nëse
2 ata e dinë, sipas rregullës 107, cili është vëllimi, kur mund
3 t'i marrim këto materiale sepse tani e kemi të qartë që duhet
4 të bëjmë një kërkesë lidhur me këto materiale dhe ne do të
5 duam që të kemi një mundësi që ta rithërrasim këtë dëshmitar
6 në qoftë se këto materiale janë me vlerë për ne.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
8 [Përkthim]

9 Z. Prokuror, doni të përgjigjeni?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Po, do të kundërpërgjigjemi. Ka
11 mundësi në fakt që mund të përdorim rregullën 107 për këtë.

12 Të jemi të qartë. Të gjithë këtu jemi të barabartë. S'ka
13 asnjë padrejtësi. Nuk e kemi as ne materialet. Prandaj s'i ka
14 as Mbrojtja materialet.

15 Sidoqoftë, ky dëshmitar, për këtë dëshmitar është bërë e
16 qartë që në 2022 që ka materiale relevante që nuk mund të
17 nxirren në këtë rast. Dhe dëshmitari në një pikë, në një
18 moment në intervistën që i ka dhënë ZPS-së në 2022, ka lexuar
19 një faqe të një ditari, po kjo është një faqe ditari që nuk na
20 e kanë dhënë as ne, nuk e kemi idenë se ky është ky material.

21 Pra, e vetmja gjë që ka ndodhur, ndryshe ajo që ka
22 ndodhur gjatë seancës përgatitore.

23 Sikurse keni parë në email, i nderuar Gjykatës, Mbrojtja
24 e Veselit ka kërkuar që të diskutojë vetëm një fakt për të
25 cilin i ka përdorur materialet dëshmitari për t'u rifreskuar

1 dëshmitari, ka qenë thjesht data e një ndeshjeje futbolli në 1
2 gusht të 1999, pra, për këtë ka dashur dëshmitari që të
3 rifreskojë kujtesën. Dhe ka bërë disa verifikime të vogla të
4 materialeve sepse nuk mund të ishte shumë i saktë për të
5 dhënat.

6 Pra, për sa i takon asaj që do të thotë dëshmitari, do ta
7 keni mundësinë sot, dëshmitari këtu do të jetë sot. Mund t'i
8 bëni kundërpyetje. Dhe nëse Mbrojtja gjykon që gjatë
9 kundërpyetjeve do t'i shkaktohet ndonjë padrejtësi, atëherë le
10 ta trajtojmë këtë në momentin e duhur.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësoj që
12 ju keni komunikuar paraprakisht për këtë, të paktën keni
13 sqaruar disa aspekte. Ma merr mendja që sot nuk do të marrim
14 ndonjë sqarim të mëtutjeshëm, kështu që vijojmë me dëshminë e
15 dëshmitarit. Ju do të merrni informacione shtesë mbase edhe
16 vetë Prokuroria mund të marrë informacione shtesë dhe sikurse
17 tha dhe Prokurori.

18 Nëse gjatë kundërpyetjeve, ju vlerësoni që mund të keni
19 nevojë ta rithërrisni këtë dëshmitar, atëherë Trupi Gjykses do
20 ta shqyrtojë këtë mundësi. Tani le të vazhdojmë.

21 Kishit diçka edhe për kalendarin dhe për orarin?

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po. Dëshëm t'ju pyesim a duhet ta
23 trajtojmë tani?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, le ta
25 trajtojmë tani.

1 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] A keni pasur mundësi të shihni
2 dokumentin që kemi dorëzuar të premtën?

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

4 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju faleminderit. Pra, e keni parë
5 kërkesën që ka bërë Mbrojtja e Veselit dhe arsyet që
6 parashtrohen në të. Ne kemi kërkuar që të trajtohet sot kjo,
7 është thjesht një parashtrim por ky do të ketë një ndikim
8 shumë të madh si tek ZPS-ja, si tek Mbrojtja.

9 Pra, çfarë themi ne, duke marrë parasysh ndryshimin e
10 personelit dhe Ekipit të Mbrojtjes është e rëndësishme që ta
11 miratoni kërkesën tonë. Përpara se unë të bëj parashtrime të
12 hollësishme, a mund t'i bëj në seancë private?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Të kalojmë në seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

6 jemi në seancë publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Atëherë dhe një herë për procesverbal, z. Thaçi, z.

9 Selimi dhe z. Veseli janë të pranishëm në sallën e gjyqit,
10 ndërkohë që z. Krasniqi na ndjek përmes videolidhjes.

11 Znj. Sekretare, ju lutem na sillni dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,

14 Dëshmitar. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Na dëgjoni?

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, ju dëgjojmë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja

17 seancës do t'ju japë tekstin e deklaratës solemne që ta lexoni

18 në pajtim me rregullën 141(2) të Rregullores. Ju lutem,

19 lexojeni me zë.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e

21 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj

22 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe

23 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të

24 cilën kam dijeni.

25 DËSHMITARI: STEVEN RUSSELL

1 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
3 Mund të uleni.

4 Palët dhe pjesëmarrësit mund të kenë vënë re që kemi tre
5 përfaqësues të Qeverisë Amerikane që është -- janë të
6 pranishëm në sallën e gjyqit. Njëri prej tyre është i ulur
7 ngjitur me dëshmitarin. Ndërkohë që dy të tjerë janë ulur pas
8 Mbrojtësit të Viktimave. Do i kërkoja secilit prej këtyre
9 personave që të prezantohet për procesverbal, duke filluar me
10 majorin Kyle.

11 Z. KYLE: [Përkthim] Përshëndetje. Unë jam Jeffrey Kyle
12 dhe përfaqësoj dëshmitarin sot.

13 ZNJ. HART: [Përkthim] Përshëndetje. Unë jam Regina Hart
14 nga Departamenti i Shtetit Amerikan.

15 ZNJ. SATPATHY: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Ankita
16 Satpathy dhe jam gjithashtu përfaqësuese e Departamentit të
17 Shtetit Amerikan.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
19 të treve që jeni pjesë e këtij procesi gjyqësor. Në qoftë se
20 do ju duhet që të konsultoheni me dëshmitarin ose në qoftë se
21 doni t'i thoni diçka Trupit Gjyqësor, ju lutem, ngrini dorën
22 dhe prisni që t'ju japë leje Trupi Gjyqësor për të folur. Në
23 qoftë se mendoni që një pjesë e dëshmisë së dëshmitarit duhet
24 të redaktohet ose në qoftë se keni diçka tjetër që doni ta
25 diskutoni në mënyrë private me dëshmitarin, ju lutem, lirisht

1 na e thoni këtë gjë dhe Trupi Gjykes do të vendosë lidhur me
2 kërkesën tuaj.

3 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
4 planifikohet që të zgjasë mesatarisht një ditë. Sikurse e
5 dini, Prokuroria do t'ju bëjë fillimisht pyetje. Dhe pasi të
6 ketë përfunduar Prokuroria, Ekipet e Mbrojtjes do të kenë të
7 drejtën që t'ju bëjnë pyetje juve, ashtu siç edhe anëtarët e
8 Trupit Gjykes.

9 Prokuroria ka vlerësuar që i duhet një orë e gjysmë për
10 t'ju marrë në pyetje. Ekipet e Mbrojtjes kanë vlerësuar se ju
11 duhen pesë orë për kundërpjetje. Sikurse dhe në raste të
12 tjera, ne shpresojmë që Ekipet e Mbrojtjes dhe Prokuroria të
13 jenë efikas në përdorimin e kohës.

14 Trupi Gjykes mund të lejojë pyetje plotësuese në qoftë
15 se përmbushen kushtet përkatëse për këtë gjë.

16 Dëshmitar, përpiquni që t'i jepni përgjigje pyetjeve që
17 do t'ju bëhen. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, mund t'i kërkon
18 palës përkatëse për të dhënë shpjegime dhe për të formuluar në
19 mënyrë tjetër pyetjen.

20 Në qoftë se ZPS-ja ju kërkon që të bëni disa korrigjime
21 lidhur me dëshminë tuaj, ju kujtohet që për procesverbal që
22 deklarata e shkruar siç është korrigjuar prej korrigjimeve
23 përkatëse duhet që të pasqyrojnë në mënyrë të saktë, duhet të
24 pasqyrohet në mënyrë të saktë në deklaratën tuaj.

25 Gjithashtu, është e rëndësishme që të flisni pranë

1 mikrofonin, të bëni një pauzë prej pesë sekonda për t'ju kapur
2 plotësisht përkthyesit.

3 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi përpara Trupit
4 Gjykues, nuk lejoheni që të diskutoni me askënd jashtë kësaj
5 salle gjyqi lidhur me përmbajtjen e dëshmisë. Nëse ndonjë
6 person vjen dhe ju bën pyetje lidhur me dëshminë tuaj përpara
7 Trupit Gjykues, ju lutem na e thoni këtë gjë.

8 Nëse ju kërkoj që të ndërprisni së foluri, duhet të
9 ndërprisni së foluri ose në qoftë se më shikoni që ngre dorën,
10 po ashtu duhet të ndërprisni së folurit.

11 Në qoftë se ju duhet të akuzuarit bëni ndonjë pushim, na
12 e thoni këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet përkatëse.

13 Tani do të vazhdojmë me dëshminë tuaj, sikurse e thashë
14 edhe më herët, Prokuroria do t'ju bëjë së pari pyetje.

15 Kështu që i jap fjalën z. Halling për të filluar.

16 Pyetje nga z. Halling:

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Jemi takuar më herët. Dhe unë sa
19 për prezantim jam z. Halling nga ZPS-ja dhe do të jem personi
20 që do t'ju bëj pyetje sot. Si fillim, ju lutem, na thoni si
21 quheni?

22 PË. Quhem Steven Russell.

23 PY. Kur dhe ku keni lindur?

24 PË. Kam lindur më 25 maj 1963 në Oklahoma, në Shtetet e
25 Bashkuara.

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 19

1 PY. Z. Russell, a jeni intervistuar më herët në dy raste nga
2 ZPS-ja?

3 PË. Po.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së seancës
5 të paraqesë në ekran dokumentin 103, faqja 1 dhe dua që ta
6 paraqisni në ekran jo për transmetim për publikun ndërkohë.

7 PY. Dëshmitar, besoj që e shikoni përpara ekranit një
8 intervistë që mban datën 14 tetor 2021. A është intervista e
9 para e juaj kjo?

10 PË. Po.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të
12 paraqesë në ekran dokumentin 106349-TR.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
14 përsëriteni dhe një herë, z. Halling.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Po, patjetër. Është dokumenti
16 106349-TR-ET Pjesa 1, faqja 1.

17 PY. Dëshmitar, a shikoni një deklaratë në ekran që mban datën
18 5 maj 2022? Dhe a është deklarata e dytë e juaj kjo?

19 PË. Po, është e saktë.

20 PY. Kohët e fundit a ju është dhënë mundësia që të njiheni
21 dhe një herë me përmbajtjen e deklaratave të dhëna prej jush
22 më herët?

23 PË. Po, përpara një jave.

24 PY. Në seancën përgatitore, ju keni bërë me dije disa
25 ndryshime dhe sqarime në këtë intervistë, a është e saktë kjo?

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 20

1 PË. Po, është e saktë.

2 PY. Dhe këto ndryshime janë pasqyruar në një shënim të cilin
3 më pas ne jua kemi lexuar ju, a është e saktë kjo?

4 PË. Po, është e saktë.

5 PY. A konfirmoni që ajo çfarë keni lexuar në këtë shënim
6 pasqyron në mënyrë të plotë dhe të saktë ndryshimet e dhëna
7 prej jush?

8 PË. Po.

9 PY. Duke marrë parasysh ndryshimet në këtë shënim,
10 intervistat tuaja a pasqyrojnë me saktësi atë çfarë keni thënë
11 dhe atë çfarë do të thoni në qoftë se do ju pyesnin përsëri në
12 Gjykatë sot?

13 PË. Po.

14 PY. Faleminderit.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pas
16 përmbushjes së kushteve të rregullës 154 dhe në pajtim me
17 vendimin F02489, ZPS-ja paraqet këto dokumente për pranim si
18 prova gjyqësore, përkatësisht janë dokumentet 130753-TR dhe
19 106349-TR në shqip dhe në anglisht së bashku me Shënimin
20 Përgatitor numër 1, që është dokumenti 122336 deri në 122342.
21 Këto materiale përfshijnë prova materiale shoqëruese të
22 identifikuara në poshtëshënimin 85 të vendimit për rregullën
23 154.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni
25 kundërshtime?

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 21

1 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes, "Nuk kemi kundërshtime".

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
3 103757-TR dhe 106349-TR pranohen si prova gjyqësore së bashku
4 me materialet shoqëruese dhe Shënimin Përgatitor numër 1 që
5 aktualisht mban numrin 122336 deri në 122342.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju kërkoj
7 ndjesë po dua të korrigjoj numrin ERN të Shënimit Përgatitor
8 numër 1. Është dokumenti me numrin 122330 deri në 122335. Ju
9 kërkoj ndjesë për këtë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Shënimi Përgatitor me numër identifikimi 122330 deri në
12 122335, pranohet si provë gjyqësore. Provat shoqëruese
13 pranohen po ashtu dhe do t'ju jepet një dokument, do t'ju
14 shpërndahet një dokument që tregon numrat e provave materiale
15 të këtyre materialeve që unë sapo citova.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Palët dhe Trupi Gjykses
17 do të marrë numrat e provave materiale dhe materiale të
18 përmendura më herët nga Gjykatësi pas pak.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. Halling, mund të vazhdoni.

21 Z. HALLING: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, ka disa çështje, ka pak çështje që doja të
23 sqaroja me ju lidhur me dëshminë e dhënë.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Dua të filloj së pari dhe lidhur
25 me këtë do i kërkoja Sekretares të paraqesë në ekran

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 22

1 dokumentin 078199 deri në 078204, do të fillojmë nga faqja e
2 parë e këtij materiali.

3 PY. Dëshmitar, shikoni një dokument që keni përpara në ekran,
4 që fillon me titullin "Sipërmarrja e çmilitarizimit dhe
5 transformimit nga UÇK-ja". A keni qenë i njohur me përmbajtjen
6 e këtij dokumenti gjatë luftës?

7 PË. Përderisa ai lidhet me marrëveshjen teknike-ushtarake dhe
8 me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara me numrin 1244, po.

9 PY. Në rregull.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Dua që të kalojmë tek faqja 078202
11 dhe të shikojmë nenin 23 drejt fundit të faqes.

12 PY. Dëshmitar, ju keni diskutuar për ende magazinimi ose
13 vende të mbajtjes të armëve gjatë deklaratës tuaj. Këtu në
14 pikën 23(a), ju thoni që:

15 "Brenda 7 ditësh, UÇK-ja do të krijojë ambiente
16 magazinimi të sigurta për armët, që do të regjistrohet dhe të
17 verifikohen nga KFOR-i."

18 A është bërë ky diskutim gjatë periudhës kur ju keni qenë
19 në lidhje me Kosovë, Dëshmitar?

20 PË. Po, kështu e kemi kuptuar ne.

21 PY. Keni folur gjithashtu edhe për pika mbledhjeje ose
22 grumbullimi të armëve. Për shembull, në nenin 23(b) ju thoni
23 që:

24 "UÇK-ja do të lirojë pozicionet e luftimit sikurse është
25 rënë dakord me COMKFOR-in në JIC."

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 23

1 Për këtë bëhet fjalë kur keni diskutuar në dëshminë tuaj
2 sa i takon këtyre pikave të grumbullimit të armëve?

3 PË. Po.

4 PY. Në dëshminë tuaj, ju gjithashtu flisni për kartelat JIC.
5 Kur i referoheni JIC, a e keni fjalën këtu për Komisionin e
6 Përbashkët për Zbatim [KPZ] që keni diskutuar në dëshmitë
7 tuaja?

8 PË. Po.

9 PY. Në qoftë se do të kalojmë tek faqja tjetër dhe në fakt
10 është neni 23(c) në fillim, ju thoni që:

11 "Pas shtatë ditësh armët e vogla që nuk janë magazinuar
12 në vendin për magazinimin e regjistruar të armëve do të mbahen
13 vetëm në zonat e autorizuara për mbledhjen e tyre."

14 A e keni kuptuar që kjo do të ndodhte nga UÇK-ja në atë
15 kohë?

16 PË. Po.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të kalojmë dy faqe më tej,
18 më konkretisht do të kalojmë tek faqja 078201.

19 PY. Sikurse mund ta shikoni, ky është vazhdimi i nenit 10.
20 Neni 10 flet për faktin që UÇK-ja, e kam fjalën këtu, tani po
21 flasim për nenin 10(d), domethënë, që:

22 "UÇK-ja angazhohet që për të mos sulmuar, për të mos
23 ndaluar apo kërcënuar asnjë civil në Kosovë ose që të mos
24 konfiskojnë ose të dhunojnë pasuri të civilëve në Kosovë".

25 A e kuptoni këtë që UÇK-ja është zotuar apo ka marrë

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 24

1 përsipër detyrimin për të mos e bërë këtë që unë sapo lexova
2 në zonën ku keni funksionuar ju?

3 PË. Po.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek faqja e
5 fundit e kësaj deklaratë, kjo është për Trupin Gjykses
6 kryesisht

7 PY. Pra, në qoftë se do të shikojmë këtë dokument, siç e
8 shikoni, është një dokument që mban datën 21 qershor 1999,
9 është nënshkruar nga Hashim Thaçi dhe është nënshkruar po
10 ashtu edhe nga Mike Jackson.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që
12 ky dokument të pranohet si provë gjyqësore.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni
14 kundërshtime?

15 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kanë
17 kundërshtime palët, kështu që dokumenti 078199 deri në 078204
18 pranohet.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
20 dokumenti merr numrin e provës materiale P01444 dhe
21 klasifikohet si konfidencial.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të
23 klasifikohet si publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
25 Riklasifikoheni si publik materialin, ju lutem.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. HALLING: [Përkthim]

3 PY. Z. Russell, pavarësisht këtyre rregullave, sipas përvojës
4 tuaj, UÇK-ja këto rregulla përmes të cilave kishte rënë dakord
5 përmes kësaj marrëveshjeje a i respektonte?

6 PË. Ata krijuan një zonë mbledhjeje për armët në zonën tonë.
7 Po ashtu dorëzuan disa armë në vendet e magazinimit të armëve.
8 Por sa i takon konsistencës së këtyre angazhimeve, nuk ka
9 ndodhur kështu.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë tani që
11 të paraqesë në ekran dokumentin SITF400780, do i kërkoja që të
12 paraqiste të dy versionet në shqip dhe në anglisht në ekran.

13 PY. Dëshmitar, mund ta shikoni në të djathtë të ekranit bëhet
14 fjalë për një dokument, një urdhëresë që pretendohet që të
15 mbajë datën 6 gusht 1999 nga zona e Karadakut, pra, është një
16 urdhëresë përmes të cilit i jepen në shfrytëzim ndërmarrjes
17 Kompakt në Gjilan pompat e karburantit ndërmarrjes. Me çfarë
18 kemi kuptuar juve nuk e keni parë përpara seancës përgatitore
19 asnjëherë këtë dokument, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. A jeni në gjendje që të njihni nënshkrimin e Ahmet Isufit
22 në këtë dokument?

23 PË. Po, se e kam parë në dokumente të tjera.

24 PY. Ahmet Isufi a është lejuar që të vendosë që ndërmarrjen
25 Kompakt të mund ta lejonte që të përdorte pompat e karburantit

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 26

1 të ndërmarrjeve të tjera?

2 PË. Kjo do të shkelte Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1244.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Përsëri do i kërkoja Sekretarisë
4 që të paraqesë në ekran dy dokumente në shqip dhe në anglisht,
5 përkatësisht këto dokumente janë 00126 është një dokument i
6 cili është në dy versione, është një dokument një faqesh në
7 versionin në shqip dhe në anglisht.

8 PY. Dëshmitar, besoj se e lexoni dokumentin që është
9 "Autorizim policia" tek pjesa e fundit e kartës dhe këtu
10 thuhet që:

11 "Poseduesi i këtij letërnjoftimi zyrtar, është personi i
12 autorizuar zyrtar që ka të drejtë të mbajë armë zjarri dhe ta
13 përdorë atë në rastet e parapara në ligj, të bëjë legjitimimin
14 e personave dhe t'i sjellë ata në organet e policisë, të hyjë
15 në banesë të hyjë pa leje, të shërbehet me mjete të huaj të
16 transportit dhe me telefon, si dhe të konfiskojë mjetet të
17 cilat janë në kundërshtim me ligjin."

18 Dëshmitar, a keni parë autorizime ose dokumente,
19 autorizime policie të kësaj natyre?

20 PË. Jo vetëm që i kemi parë, por edhe i kemi sekuestruar ato
21 sa herë që jemi hasur me ta ose jemi hasur me personat që kanë
22 bërë punë të paautorizuar policie.

23 PY. Besoj që është e qartë nga përgjigja që dhatë që e keni
24 sekuestruar sepse ishin autorizime të paligjshme, apo jo?

25 PË. Po, sepse autorizimet i jepnin vetëm Kombet e Bashkuara,

1 për këtë arsye.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe një herë tjetër do kërkoja që
3 të paraqitet në ekran një dokument që mban numrin
4 SPOE00226883. Sërish është një dokument prej një faqeje dhe
5 doja të kërkoja të paraqitej ky dokument si në shqip dhe në
6 anglisht.

7 PY. Dëshmitar, mund të shihni në ekran një kartë ku thuhet
8 Ministria e Rendit Publik, letërnjoftim zyrtar për Selim
9 Krasniqin. A keni parë karta ose letërnjoftime të tilla të
10 ngjashme në duart e UÇK-së në atë kohë?

11 PË. Po, kemi parë letërnjoftime të kësaj natyre. Po ashtu
12 kemi parë dhe dokumente të paligjshme të qeverisë gjithashtu
13 edhe letërnjoftime ose fletë identifikimi të paligjshme të
14 cilat nuk e kishin marrë miratimin nga instancat përkatëse.

15 PY. Pra, siç e keni thënë, juve nuk e dinit se kush ishte
16 ministri i rendit publik në UÇK në atë kohë, apo jo?

17 PË. Me zhvillimet e mëtejshme neve u mësua dhe morëm
18 informacion për struktura të mëtejshme, megjithatë në fillim
19 fare neve nuk e dinim se kush ishin shumë prej anëtarëve të
20 qeverisë në atë kohë.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këtu them, në
22 qoftë se mund ta shikoni, pra, në fund fare të këtij dokumenti
23 thuhet "Ministri i Rendit Publik Rexhep Selimi" dhe ka një
24 nënshkrim aty.

25 Do kërkoja që dokumenti të paraqitej si provë. Është

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Page 28

1 dokumenti SITF40007080 dhe më pas dokumenti SPOE00226926 dhe
2 në fund fare SPOE00226883. Dy dokumentet e fundit janë
3 sekuestruar nga shtëpia e Rexhep Selimit.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për dokumentin
5 e parë kundërshtojmë që të pranohet, sepse ky është një
6 dokument që dëshmitari qartazi nuk e ka parë më herët dhe ai
7 nuk është pyetur lidhur me përmbajtjen e dokumentit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
9 përgjigje?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Unë bëra pyetje lidhur me
11 përmbajtjen dhe i bëra pyetje dhe i thashë në qoftë se lejohej
12 kjo apo jo dhe ai tha që nuk lejohej.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
14 tjetër?

15 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
17 SITF40007080 pranohet si provë gjyqësore.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky
19 dokument dhe përkthimi i tij në anglisht do të marrë numrin e
20 provës P01532. Dhe do të klasifikohet si konfidencial.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00226926
22 pranohet si provë gjyqësore.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
24 numrin e provës P01533. Dhe do të klasifikohet po ashtu si
25 konfidencial.

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 29

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe, në fund,
2 dokument SPOE002206883 pranohet si provë gjyqësore.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
4 dokumenti dhe përkthimi i tij në anglisht do të marrin numrin
5 e provës P01534. Klasifikimi është konfidencial.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
7 Mund të vazhdoni, z. Halling.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 Sa për procesverbal, sa i takon dokumentit të fundit, pra,
10 provës P01534, duhet të lidhet me provën P69.

11 PY. Dëshmitar, e diskutuat pak këtë. Megjithatë do të bëj një
12 pyetje sa i takon zonës ku funksiononit ju në periudhën korrik
13 ose qershor deri në shtator 1999, kush ishte i autorizuar për
14 të bërë policim të ligjshëm, pra, kush kishte përgjegjësi për
15 të bërë veprime policie?

16 PË. Rezoluta e Kombeve të Bashkuara 1244 ka funksionuar së
17 bashku dhe efektiviteti i kësaj rezolute është realizuar në
18 përputhje me forcat e NATO-s. Pjesët e ushtrisë së Kombeve të
19 Bashkuara dhe Brigada e Lindjes, Brigada Multikombëshe e
20 Lindjes dhe ne kemi pasur këtë përgjegjësi, domethënë, kemi
21 pasur përgjegjësinë për të vendosur rend. Dhe me barrën që
22 kishin njësitë ushtarake, Kombet e Bashkuara, pra, kishin,
23 qeverisjen legjitime dhe institucionet të cilat do të
24 realizonin verimet e policisë dhe gjëra të tjera.

25 PY. Në periudhën që unë përmenda dhe më herët, nga qershori

1 deri në shtator të 199, policia e UNMIK-ut a ka qenë aktive në
2 atë periudhë?

3 PË. Jo, në praktikë në atë kohë nuk ka qenë aktive. Pra,
4 pjesa e logjistikës e tyre ka qenë zbatuar, megjithatë gjatë
5 tre muajve të parë të misionit nuk ka pasur prani të policisë
6 së Kombeve të Bashkuara që më kujtohet mua. Ka pasur disa
7 persona ndërlihdjeje, ka pasur plane për të ardhmen dhe
8 rekrutime, pra, janë bërë punë të tilla të kësaj natyre gjatë
9 gushtit dhe shtatorit të 1999. Dhe nga fundi i vitit, ne
10 filluam që të shikonim që të formësohej një forcë policie e
11 kombeve të bashkuara që ishte ndërkombëtare në natyrë.

12 PY. Në qoftë se e kuptova drejtë gjatë periudhës që po
13 diskutojmë, forcat e vetme legjitime të policisë në atë zonë
14 keni qenë ju, domethënë, KFOR-i, apo jo?

15 PË. Po, kështu ka qenë.

16 PY. Ju lutem, na shpjegoni burimet që ka pasur në dispozicion
17 KFOR-i Amerikan për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht
18 krime gjatë kësaj periudhe?

19 PË. Duhet që të kuptoni njësinë ushtarake të madhësisë që
20 kishim ne dhe ne kishim shumë burime që jepnin një vijë
21 ndarëse ndërmjet hetimit dhe policimit dhe kishim gjithashtu
22 dhe një lloj natyre standarde këmbësorie për të cilën ishim
23 gjithashtu të përgjegjshëm. Kishim njësi të policisë ushtarake
24 të cilët ishin trajnuar për çështje ligjore dhe për policim
25 dhe hetim. Kishim gjithashtu edhe shtabin ose departamentet e

1 gjykatësve që kishin avokatë të kualifikuar të cilësuar në
2 ushtri. Dhe këto ishin instancat të ndërlidhura.

3 Përgjegjësia jonë në njësinë e këmbësores ishte që
4 ndërkohë që do të haseshim me gjëra të një natyre gjithmonë e
5 më tepër policore, i takonte që ne do të përdornim burime që
6 kishim në dispozicion. Në forcat tona, sa më kujtohet mua, ne
7 kemi pasur një batalion të policisë ushtarake dhe kishim dhe
8 kompani që ishin caktuar për sektorë të ndryshëm. Për
9 shembull, kemi pasur kompaninë e parë MP që ka qenë e
10 bashkëlidhur konkretisht me Task Forcën tonë. Pra, domethënë,
11 me fjalë të tjera, kemi pasur shumë burime policore që kanë
12 qenë të disponueshme për ne gjatë kësaj periudhe.

13 PY. Gjatë hetimeve të KFOR-it Amerikan që po përshkruanit ju,
14 a keni bërë hetim të akuzave për krime nga të gjitha palët në
15 mënyrë të barabartë?

16 PË. Po. Ndërsa ne futeshim në zonën e funksionimit, pak
17 ushtarë amerikanë kishin pak njohuri të shqipes dhe të serbo-
18 kroatishes si gjuhë ose të kulturave të këtyre vendeve.
19 Kështu që ne i kemi parë gjërat ashtu siç i kemi parë në pamje
20 të parë sa i takon ndodhive ose ngjarjeve dhe kemi vlerësuar
21 mbi këtë bazë në qoftë se ato ishin të drejta ose të gabuara.

22 PY. Po udhëheqja, udhëheqësit e UÇK-së me të cilët ju keni
23 bashkëbiseduar, a ju kanë referuar ndo një hetim të bërë prej
24 jush?

25 PË. Si oficer operacionesh i këmbësores, pra, i forcës së

1 Task Forcës së këmbësisë, ata më njoftonin në mënyrë të
2 menjëhershme, për shembull, në qoftë se duhej që të
3 ndërmerreshin veprime për sa i takon akteve të paligjshme
4 sipas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1244.

5 Ndërkohë që ne i dëgjonim fshatarët, i dëgjonim ish-
6 zyrtarët ose personat të cilët donin që të merrnin pozicione
7 drejtuese, ne kemi dëgjuar ata, i kemi dëgjuar mendimet e tyre
8 ose njerëzit që kanë pasur ndikim mbi xhamitë ose kishat.
9 Megjithatë, sa i takon bashkëpunimit me institucionet, ish-
10 institucionet ose për sa i takon aspekteve të paligjshme, nuk
11 ka qenë kështu.

12 PY. T'ia u bëj pak ndryshe pyetjen në mënyrë të tillë që të
13 marrë një përgjigje më të qartë. Pra, sa i takon udhëheqjes së
14 UÇK-së që ju përmendët lidhur me krimet e kryera nga ushtarët
15 e UÇK-së, këto a ishin krime ose veprime të cilat hetoheshin
16 prej jush?

17 PË. Po, patjetër. Pra, siç kemi bërë, për shembull, me
18 aktivitetet e çetnikëve, ne kemi pasur gjithashtu, le të
19 themi, ndikim edhe në raste të tilla, ashtu siç kemi bërë dhe
20 hetime edhe sa i takon veprimeve të bëra nga serbët.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shoh që ora
22 është 10.00. Në qoftë se dëshironi të bëni një pushim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë një
24 pushim dhjetë minutash. Mund të largoheni nga salla e gjyqit.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
2 ndërpritet, dhjetë minuta pushim.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

4 --- Seanca rifillon në orën 10.11

5 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Punonjëse
6 e Gjykatës, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni.

9 Në rregull. Z. Halling, mund të vazhdoni.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

11 PY. Mirë se u kthyer, z. Dëshmitar. Një pyetje të fundit
12 lidhur me temën për të cilën po bisedonim përpara pushimit.

13 Nga qershori-shtator 1999, a ka patur prani të Gjykatës
14 Penale Ndërkombëtare në Kosovë?

15 PË. Më kujtohet që ka patur prani të TPNJ-së, po.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Tani duam të kalojmë te një
18 dokument që është pranuar, që mban numrin P1518, faqja 105928.

19 Në qoftë se mund ta shfaqim në ekran, ju lutem.

20 PY. Z. Dëshmitar, do të shfaqim një faqe që përmban
21 Paraqitjen Historike Vjetore dhe do të bisedojmë, do të bëj
22 disa pyetje lidhur me dëshminë që keni dhënë ku janë bërë
23 pyetje lidhur me operacionet që keni përshkruar. Pra, këtu
24 shihet 16 korrik 1999:

25 "CPT Doug Willis, komandati i B/1-71AR [Sipas përkthimit]

1 shpëtoi një mashkull serb nga zona, pika e bashkimit të UÇK-së
2 në Malishevë.”

3 Disa pyetje. Së pari, në qoftë se ju e dini ky Doug
4 Willis nga e mori informacionin që dikush ishte kidnapuar në
5 Sillovë?

6 PË. Dhe unë do t’i referohem hartave që janë në gjuhën Serbo-
7 Kroate sepse këto kanë qenë hartat që kishim në dispozicion në
8 atë kohë. E di që tani është ndryshe.

9 Kapiteni Doug Willis, komandanti i komandimit --
10 kompaninë që ishte pjesë e Task Forcës tonë dhe në rrugën
11 kryesore që shkonte përmes Gjilanit në veri ishte një qytet i
12 vogël, pra Sillovë. Ai mori këtë informacion. Ata e kanë parë
13 automjetin Hamvee, që ishte element i KFOR-it, dhe i thanë
14 atij që një person mbahej i kidnapuar, pra rrëmbyer në një
15 fushë afër aty. Persona -- ata thanë, treguan vendin ku
16 mendonin që ai mbahej dhe kështu kanë filluar veprimet nga
17 kapiteni Willis.

18 PY. A keni ndonjë informacion se si ky bujk u transferua pra,
19 nga Sillova në pikën e mbledhjes së -- grumbullimit në
20 Malishevë?

21 PË. Mesa kemi marrë ne informacion ai është transportuar me
22 një Zastava, kamion, me ngjyrë si një mbulesë, pra, ngjyrë
23 portokall të zbehur dhe është gjetur në pikën e grumbullimit
24 në Malishevë.

25 PY. Është kjo ajo që keni përshkruar, i njëjti kamion i

1 llojit Zastava që është pastaj më vonë sekuestruar nga KFOR-i?

2 PË. Po, kështu është.

3 PY. Kur bujku më në fund u kthye, pastaj cili ishte reagimi i
4 njerëzve në Sillovë për kthimin e tij, pra?

5 PË. Ata ishin të befasuar në shok, të tronditur. Ne
6 personalisht e kthym atë në qytetin e Sillovës. Ishte i ulur
7 në pjesën prapa të automjetit, dhe kur doli ata ishin të
8 tronditur.

9 PY. A mund të na jepni ndonjë hollësi të mëtejshme se si e
10 dini ju që ata ishin të tronditur?

11 PË. Ata qanin, e përqafonin, kishin menduar se nuk do ta
12 shihnin më kurrë. Pra, ishin shumë mirënjohës.

13 PY. A kishin frikë se do të vritej ai?

14 PË. Po. Dhe ata nga -- aty kishte shprehje -- shprehje të
15 gëzimit dhe jepnin edhe emra të tjerë personash të cilët ishin
16 të rrëmbyer për të cilët nuk dinin asgjë.

17 PY. Ajo që kemi këtu në ekran, këtu thuhet që ky person u
18 detyrua që të nënshkruante rrëfime, apo pranim të fajit. Të
19 detyruara, pra, të rrejshme. Si e dini ju këtë gjë?

20 PË. Siç na raportoi kapiteni Willis, kur arriti te pika e
21 grumbullimit në Malishevë, ai dhe ushtarët e tij që realizuan
22 lirimin e mashkullit të rrëmbyer aty gjetën këtë shënim dhe
23 gjetën se ku ishte marrë në pyetje dhe ishin në gjendje, pra,
24 ta lironin atë. E morën pastaj në ruajte të tyre.

25 PY. Bujku i rrëmbyer a u -- pra, tha, deklaroi që ishte

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 36

1 rrëfim i detyruar, pra?

2 PË. Po.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të shfaqim një fotografi.

4 Dhe kjo është në dokumentin 105816 deri në 106095, faqja

5 konkrete është 105979. Kemi përkthimin në anglisht të kësaj

6 faqe. Pra, do të shfaqim edhe fotografinë shqip në njërën anë,

7 dhe përkthimin në gjuhën angleze në anën tjetër.

8 PY. Dëshmitar, e njihni dokumentin në anën e majtë të

9 ekranit?

10 PË. Po.

11 PY. Çfarë është kjo?

12 PË. Duket të jetë dokumenti që individi në fjalë u detyrua të

13 nënshkruante.

14 PY. Këtu shohim një emër, Velibor Stojanovic. A është ky emri

15 i bujkut?

16 PË. Duket të jetë e saktë.

17 PY. Pra, emri i parë është Velibor apo Vladimir?

18 PË. Më duket që ishte Velibor.

19 PY. Dokumenti në qoftë se shikoni përkthimin në anglisht në

20 anën e djathtë përshkruan rreth 150 të rinj të armatosur, 20

21 pistoleta. Thotë që, "Bora Stankovic ka mitraloz të rëndë.

22 Moncilo Pavic nga Budriga". Cili është vlerësimi juaj për

23 arsyen sepse është shkruar ky rrëfim i rrejshëm. Për çfarë

24 është përpiluar?

25 PË. Ajo që kemi parë në dokumente të tjera që kemi konfiskuar

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 37

1 është që kjo do të përbënte pastaj bazën për të -- ose
2 rrëmbyer ose shënjestruar me mjete të tjera njerëz që
3 përmenden në këto lista.
4 PY. Faleminderit.

5 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkojmë që
6 kjo fotografi të pranohet si provë. ERN-ja është 105979 dhe
7 përkthimi i tij në anglisht.

8 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
9 kundërshtim? Nuk ka kundërshtime.

10 105979 pranohet, të dyja, versioni në serbisht dhe
11 përkthimi në anglisht.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faqja konkrete dhe
13 përkthimi në fjalë në anglisht do të marrë numrin e provës
14 materiale P015535. Dhe klasifikimi është konfidencial.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

16 PY. Dëshmitar, tani do të doja të kalojmë në një faqe në --
17 të deklaratës suaj dhënë ZPS-së.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Numri është P1510.2 faqe 46.
19 Versioni në anglisht është i mjaftueshëm dhe mund të shfaqet
20 në ekran.

21 PY. Dëshmitar, do të doja tani t'ju pyes për operacionin për
22 të cilin është -- të cilin e kemi diskutuar gjatë në dëshminë
23 tuaj të datës 9 gusht 1999. Në këtë pjesë të deklaratës tuaj
24 ju flisni për Ahmet Isufin, dhomën e torturimit. Dhe ju
25 deklaroni:

1 "E kanë futur atë në dhomë. Më kujtohet lëvizje dhe gjak
2 në dysHEME, instalime elektrike, priza që ishin aty, tela afër
3 një karrige. Kishte shkopinj, një gyp. Disa shkopinj ishin
4 aty, pra nuk -- ishte e thjeshtë të kuptohej se çfarë po
5 ndodhte aty."

6 Duke u përqendruar tek përshkrimi juaj nga përshkrimi,
7 pra paraqitja e dhomës se si dukej përbërja, na përshkruani ku
8 ishte në dysHEME gjaku.

9 PË. Mesa më kujtohet kur jemi futur në bodrum në anën e
10 djathtë ishte një vend ku ishte si një pjesë e ndarë, një
11 karrige, dhe disa instrumente të mprehtë. Kishte njolla gjaku
12 në dysHEME. Pra ishte e gjitha në një pjesë të izoluar, në një
13 cep, në një qoshe.

14 PY. Ku ishin njollat e gjakut krahasimisht me karrigen?

15 PË. Të gjitha këto ishin shumë afër njëra-tjetrës.

16 PY. A mund të jeni në gjendje të na thoni sasinë e gjakut që
17 ishte në dysHEME?

18 PË. Nuk ishte dhe nuk dua të jem i ha -- ta përshkruaj tepër
19 atë, nuk dukej gjakderdhje e madhe, por ishte një njollë e
20 madhe rreth 40 centimetra [Sipas përkthimit]. Dukej sikur
21 ishte -- kishte ra nga sipër, pra, dhe ishte zgjeruar ajo
22 njollë, pra. Natyrisht ishte shkaktuar nga plagë pas
23 ekzaminimit.

24 PY. Pas ekzaminimit të vendit a keni në gjendje të shihnit se
25 sa i vjetër ishte ky gjak?

1 PË. Dukej i freskët, nuk ishte i nxirë. Ushtarët e
2 këmbësorisë janë të mësuar të shohin gjëra të tmerrshme dhe
3 kjo dukej e kohëve të fundit, pra, që ishte e freskët.

4 PY. Tani kthehemi te pjesa e shkëmbimit, ku ju ia tregoni
5 këtë Ahmet Isufit. Kur ia identifikuat dhomën Ahmet Isufit, a
6 e identifikuat atë si dhomë torture, kur biseduat me të?

7 PË. Nuk më kujtohet nëse kam përdorur saktësisht këto fjalë
8 apo jo. Por, më kujtohet shumë mirë që kam -- e kam çuar atë
9 në vend dhe i kemi treguar se çfarë kemi gjetur. I kemi
10 treguar edhe problemin që përbënte kjo.

11 PY. A e -- kur arritët aty, a e pyetët se çfarë ishte kjo?

12 PË. Nuk më kujtohet saktësisht apo hollësitë e bisedës. Këto
13 kanë qenë momente tensioni. Por, më kujtohet që unë doja të
14 dija se çfarë po ndodhte.

15 PË. Ahmet Isufi të dha ty ndonjë shpjegim se çfarë po ndodhte
16 në atë dhomë?

17 PË. Ai ishte i kujdesshëm, i rezervuar. Ai e dinte që ne
18 kishim zinxhir autoriteti dhe e dinte që nuk isha në krye të
19 këtij zinxhiri dhe besoj që ai e ka përdorur këtë për të
20 fituar kohë.

21 PY. A e mohoi ai që kjo dhomë ishte përdorur për të torturuar
22 njerëz?

23 PË. Nuk dha asnjë mendim apo opinion lidhur me atë që kishim
24 gjetur. Përkundër disa të tjerëve ai nuk bëri asnjë koment
25 lidhur me atë që kishim gjetur, lidhur me armët apo dhomën e

1 torturës.

2 PY. Ju thatë "përkundër disa të tjerëve". Ndonjëri nga ata që
3 keni takuar, pjesëtarë të UÇK-së, gjatë këtij operacioni a dha
4 ndonjëri prej tyre ndonjë shpjegim lidhur me atë që ndodh në
5 këtë dhomë?

6 PË. Kur filloi operacioni, ishte -- ne prisnim që të mos
7 gjenim asgjë aty. Na thanë "Kërkoni çfarë të doni. Kontrolloni
8 çfarë të doni, nuk do të gjeni asgjë". Dhe natyrisht ne në
9 fakt gjetëm shumë aty.

10 PY. Kur gjetët dhomën e torturës, ndonjëri nga pjesëtarët e
11 UÇK-së a dha ndonjë shpjegim se për çfarë përdorej ajo dhomë?

12 PË. Jo, nuk dhanë. Neve patëm përshtypjen që ata po
13 përpiqeshin të fitonin kohë dhe të shihnin se si do të
14 vazhdonim më tej.

15 PY. Në dëshminë tuaj ju përmendni Ahmet Isufin që donte të
16 merrte në kujdesin apo ruajtjen e tij dhjetë personat që ju
17 kishit identifikuar për t'u mbajtur të ndaluar. Mendoj që kjo
18 është e qartë nga intervista juaj, por që ta bëjmë më të
19 qartë, kjo bisedë ka ndodhur pasi ju i kishit treguar atij për
20 dhomën e torturës, e saktë?

21 PË. E saktë. Unë ia bëra të qartë atij që veprimet tona ne do
22 të merrnim me vete dhjetë persona dhe doja që ai të kuptonte
23 pse. Pasi i tregova atij të gjitha gjërat, i thashë "Ne do të
24 marrim dhjetë personat në fjalë". Ai tha "Jo, do t'i marrim ne
25 ata dhjetë personat". Besoj dhe se unë i thashë "Nuk do të

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 41

1 ndodhë kështu”.

2 PY. Dhe në fakt në fund nuk ndodhi kjo gjë?

3 PË. Nuk ndodhi.

4 PY. Tani shohim disa prej raporteve të këtij operacioni dhe
5 operacione të tjera që keni bërë.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Nëse mund është kalojmë tek
7 dokumenti R091-3803 deri te R091-3802. Ta shfaqim këtë në
8 ekran, jo për publikun.

9 PY. Këtu mund të shohim që kjo është nxjerrur -- kjo është
10 nga brigada e shumëkombëshe e lindjes. Raport i brigadës
11 shumëkombëshe të lindjes. Bëhet fjalë për operacionin në
12 fjetoren ku thuhet:

13 “Dhjetëra pistoleta, granata, pajisje shpërthyesë dhe
14 qindra municione janë sekuestruar gjatë këtij operacioni. Për
15 më tepër 5 ton dokumente të paligjshme, uniforma të UÇK-së
16 janë konfiskuar në bodrum. Tre posedues të kartave të ushtrisë
17 jugosllave janë të pranishme në momentin at operacionit,
18 Adrien Mehmeti, Abdurrahmun Ramadani dhe Shaqir Shaqiri ...”

19 Janë gjetur aty.

20 Dëshmitar, së pari, keni parë këtë raport gjatë luftës?

21 PË. Po, sigurisht.

22 PY. E keni përgatitur ju këtë raport?

23 PË. Ne kishim repartet e inteligjencës, pra të zbulimit në --
24 si dhe pjesën e departamentit në operacione që na raportin në
25 shtab dhe gjatë këtyre raporteve ne kemi nxjerrur

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Page 42

1 informacionet që ju lexuat për brigadën shumëkombëshe lindje.
2 PY. Raportimi në përgjithësi i këtyre operacione është i
3 saktë, siç është përshkruar në raport?

4 PË. Është në përgjithësi, por jo, nuk përmban të gjitha
5 informacionet.

6 PY. Kuptoj. Por e saktë -- përgjigja juaj që është e saktë na
7 mjafton.

8 Z. HALLING: [Përkthim] R09138902 ne kërkojmë që kjo të
9 pranohet. Pra paraqesim për t'u pranuar si provë.

10 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
11 kundërshtim?

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asnjë nuk
14 kundërshtim. R091-3802 pranohet.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
16 dokumenti do të marrë numrin e provës materiale P01536.
17 Klasifikimi konfidencial.

18 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të doja që të flasim për
20 dy dokumente të OSBE-së. Dokumenti i parë është SITF00011502
21 deri në 00011508. Fillimisht në ekran do të doja të shikoni
22 SITF00011504.

23 PY. Dëshmitar, ndërkohë që po vendoset kjo në ekran kjo
24 thuhet që është raporti javor i misionit të OSBE-së në Kosovë,
25 11-17 gusht 1999. Në qoftë se mund të përqendrohemi në fund të

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 43

1 faqes ku përmendet që ka konfront -- përplasjet e përditshmet
2 nuk kanë të ndaluar në Gjilan pas bastisjes, kontrollit, të
3 fjetores së përdorur nga UÇK-ja dhe gjetjes së atyre që janë
4 përshkuar -- të asaj që është përshkuar si dhomë e torturës si
5 dhe armëve, municioneve, mjeteve shpërthyesë, trupat e KFOR-it
6 janë -- u rrethuan nga turmë e zemëruar. Vetëm nëntë prej
7 tridhjetë personave synoheshin të arrestoheshin janë arrestuar
8 nga KFOR-i. Të nesërmen protestat e tjera të shqiptarëve kanë
9 ndodhur kundër paqeruajtësve në përpjekje për të liruar ata që
10 mbaheshin të ndaluar.”

11 Dëshmitar, tani në dëshminë tuaj që ju thoni që ishin
12 dhjetë dhe jo nëntë persona që u mbajt -- që u ndaluan aty,
13 por ky është raporti im i përgjithshëm i operacionit këtu nga
14 OSBE-ja, është ky i saktë?

5 elementet kyç të marrëveshjes. Ndërkohë autoritetet serbe
6 dërguan 45 mijë trupa dhe në shkelje të plotë të marrëveshjes
7 që kishin bërë, duke bombarduar civilë, duke djegur shtëpitë e
8 tyre. Kemi parë njerëz të pafajshëm të larguar nga shtëpitë e
9 tyre, të detyruar të ulen në gjunjë dhe të ekzekutoheshin.
10 Meshkujt e Kosovës të larguar, të ndarë nga familjet e tyre,
11 nga prindërit e tyre dhe të vrarë. Kjo nuk është luftë në
12 kuptimin tradicional, por është një sulm me tanke dhe armë të
13 rënda ndaj personave të pambrojtur të cilët kanë luftuar për
14 paqe."

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

16 PY. A është kjo që tha presidenti Clinton në përputhje me
17 njohuritë që kishit ju për arsye që NATO-ja dhe Kombet e
18 Bashkuara do të ndërhyjnë?

19 PË. Besoj që kjo ka qenë ajo që mendonim të gjithë ne.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kërkoj që kjo të pranohet si
21 provë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk shoh rëndësinë apo relevancën,
23 megjithatë s'kemi kundërshtime.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
25 DHT04061 pranohet.

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 82

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 videoja deri në 3 minuta 27 sekonda pranohet si provë 1D00172
3 dhe klasifikimi është publik.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

5 PY. Në këtë video, presidenti flet për udhëheqësit shqiptarë
6 që kanë nënshkruar marrëveshjen për paqe. E dinit që njëri
7 prej këtyre udhëheqësve ishte Hashim Thaçi?
8 PË. Mendoj kështu, me sa, ashtu siç e kam kuptuar unë, roli i
9 tij me udhëheqësit kryesorë në NATO, ka komunikuar me ta. Nuk
10 do të isha i habitur, pra, që të ketë komunikuar.

11 PY. Faleminderit.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund ta heqim videon nga
13 ekrani.

14 PY. Sa i takon parapërgatitjeve për misionin tuaj, përpara që
15 të dislokohehit, a jeni informuar -- Bill Clinton këtu i
16 referohet krimeve që po kryheshin kundër shqiptarëve të
17 Kosovës. A jeni informuar ju përpara dislokimit tuaj për atë
18 që kishte ndodhur në Gjilan, në fakt, saktësisht?

19 PË. Në këtë fazë, në fund të dimrit apo fillim të pranverës
20 1999 ne nuk e dinim nëse serbët do të pranonin që të
21 largoheshin. Duhet të kuptoni që në atë, në këtë fazë, në
22 pranverë, kur u informua Task Forca jonë, ne me sa kuptonim që
23 do të ishte ajo që do të qëndronim në Shkup në Maqedoninë e
24 veriut sot, dhe që duhej ndoshta të ndërhyjmë, të hynim në
25 Kosovë duke përdorur forcën që duhet, përmes luftimeve. Kështu

1 mendonim ne misionin.

2 Dhe jemi ndier më mirë ne si luftëtarë që nuk u detyruam
3 të luftonim për të hyrë në Kosovë dhe që tranzicioni do të
4 ishte më i -- më paqësor. Dhe ju siguroj që këmbësoria është
5 shumë mirënjohëse për këtë.

6 PY. Unë e kam fjalën për -- pyetja ime është informimi që ju
7 jepet juve, pra, nga departamenti i shtetit. Ishit i informuar
8 se çfarë do të gjenit në, gjenit në Gjilan kur të arrinit?

9 PË. Ne kemi marrë informacione të tilla dhe Task Forca jonë,
10 që të mos e bëj gjatë, por që ta kuptojmë më mirë, ne ishim
11 dislokuar, kishim qenë në mision në Bosnjë më parë, ishim të
12 njohur, njihnim ish-Jugosllavinë. Kishim qenë në Maqedoni.

13 Task Forca jonë nga 1996 deri në 1999 kishte bërë misione
14 të shumta. Ky ishte i treti. Pra, ata ishin, njihnin shumë
15 mirë kontekstin e konfliktit dhe përbërja e popullsisë në
16 vende të ndryshme.

17 PY. Faleminderit.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim
19 raportin e Departamentit të Shtetit, nuk e di në qoftë se ju
20 jeni në njohuri, në dijeni të këtyre fakteve. Ky raport është
21 i datës 4 qershor 1999, dhe referenca është DHT03974, deri në
22 DHT03986. Faqja që më intereson është DHT30980 [Sipas
23 përkthimit] dhe ka të bëjë me Gjilanin.

24 PY. A jeni informuar lidhur me këtë që do të lexoj tani:

25 "... mes datës 7 dhe 15 prill forcat serbe raportohet të

1 kenë plaçkitur dhe abuzuar fizikisht shqiptarët në këtë qytet.
2 Sipas raporteve të refugjatëve, refugjatët e tjerë pretendojnë
3 se më 16 prill njësitë paraushtarake kanë urdhëruar të gjithë
4 shqiptarët që të largohen nga qyteti ose do të vriteshin. Të
5 paktën 1000 të zhvendosur janë larguar dhe janë kërcënuar nga
6 forcat serbe gjatë rrugës së tyre. Meshkujt janë, raportohet
7 të jenë ndarë nga konvoji pra, nga rruga dhe janë vrarë.
8 Forcat serbe raportohet të kenë urdhëruar refugjatët e tjerë
9 që të varrosin kufomat e tyre, të të paktën gjashtë
10 shqiptarëve. Dy nga trupat, nga kufomat u dogjën, ndërsa të
11 tjerë kishin vrima të shkaktuara nga plumbat pas kokës së
12 tyre.”

13 A keni marrë informacione të tilla nga Departamenti i
14 Shtetit përpara që të dislokohehit në atë vend?

15 PË. Ne e dinim që kjo ishte shumë dhunë në Brigadën
16 Shumëkombëshe Lindje. E dinim që kishte aktivitet nga tre
17 elementë serbë. Që janë Ushtria Jugosllave dhe, pra ushtria,
18 MUP-i, që është policia e tyre, dhe pastaj ishin çetnikët,
19 forca paraushtarake që nuk njiheshin nga askush.

20 PY. Faleminderit.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund ta dorëzoj këtë dokument
22 si provë, meqenëse përputhet me atë që dëshmitari ka kuptuar
23 lidhur me informacionin që ka marrë përpara që të arrinte aty?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk mendoj që kjo është ajo që tha
25 dëshmitari, që kjo që tha dëshmitari përputhet me pretendimet

1 specifike konkrete këtu. Gjithashtu, faqja e parë e këtij
2 dokumenti është dhënë, dorëzuar më 4 qershor 1999, që edhe
3 këtu i bie të jetë përpara datës së përvojës praktike të
4 dëshmitarit në Gjilan. Edhe këtu, pra, kundërshtoj për bazën
5 mbi të cilën kërkohet pranimi i këtij dokument.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Pika, çështja që rreth kësaj,
7 ka të bëjë me informacionet që kanë marrur ata përpara që të
8 arrijnë. Pra, natyrisht edhe incidenti përfshi, natyrisht
9 incidenti ka ndodhur përpara.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
11 dokumenti. DHT03974 në faqen, deri në DHT033986 [Sipas
12 përkthimit] në faqen DHT30980 [Sipas përkthimit] pranohet.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

14 PY. Është e mundur apo jo që pasi keni parë nivelin e dhunës
15 kundër shqiptarëve të zakonshëm, ata shqiptarët e zakonshëm
16 kanë kërkuar të hakmerren kundër atyre që i mbanin si
17 përgjegjës dhe në këtë rast serbët, dhe që kjo ka shkaktuar
18 shumë dhunë që ju e keni vërejtur.

19 PË. Kjo është pa rëndësi për misionin tonë, zonjë.

20 Rezoluta e Kombeve të Bashkuara thoshte, thonte që ne do
21 të ishim ushtria që do të ndalonte të gjithë këtë, dhe
22 gjithçka që ishte në favor pas marrëveshjes për ato që ne po
23 shkonim për t'i mbështetur. Dhe duhej të kishte vullnet, ata
24 kishin vullnetin e mirë të kombit dhe ne kishim një aleancë të
25 fuqishme, më të fuqishme në planet për të arritur sigurinë,

1 pra, dhe bankat botërore që do të siguronin ndihma humanitare
2 dhe kishin gjithçka në favor të tyre në mbështetje të tyre.
3 Pse duhet të hakmerreshin? Këto ishin krime kundër njerëzimit.
4 PY. I keni deklaruar ZPS-së në intervistën tuaj të parë, me
5 referencë është P01509.2, në faqen 2 [Sipas përkthimit]. Ju
6 sugjeroj që ju keni pranuar që hakmarrja që është ndodhur ka
7 ndodhur:

8 "... e gjitha provinca", siç keni thënë ju, "nuk ishte
9 gjë tjetër, por 600 vjet, 700 vjet histori hakmarrjeje në të
10 dyja anët."

11 PË. Dhe unë po përpiqem të kuptoj, ju po më kërkoni, po më
12 pyesni nëse kjo hakmarrje ishte e arsyetuar, e justifikueshme?

13 PY. Jo. Unë po ju pyes nëse kjo hakmarrje ishte shkaku që,
14 shkaku që shqiptarët e zakonshëm kryenin krime në atë kohë.

15 PË. Nga pikëpamja e ushtarit, nuk ka rëndësi sepse ne ishim
16 aty për të zbatuar marrëveshjen dhe për të ndaluar dhunën për
17 aq sa kishim mundësi.

18 PY. Por, çështja është që ju e keni pranuar, dhe pyetja ime
19 është që ju keni pranuar se hakmarrja ka ndodhur, apo jo? Dhe
20 nëse mund t'i referohemi është, mund ta shfaqim në ekran.

21 PË. Në qoftë se më lejoni, zonjë. Unë nuk kam simpati për
22 hakmarrjen e asnjërës palë.

23 PY. Dhe ju kujtohet që keni shkruar në ditarin tuaj personal
24 dhe referenca është P01519 deri në faqen 105834:

25 "Kurrë në jetën time nuk kam parë kaq urrejtje të

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 87

1 rrënjosur, mashtrim dhe mungesë të ligjit. Nëse ka Perëndim të
2 Egër në botë sot, ky ekziston në Kosovë.”

3 A qëndroni pranë kësaj deklaratë?

4 PË. Mendoj që nuk e bën atë të justifikueshëm, por përshkruan
5 situatën, gjendjen se si ishte.

6 PY. Faleminderit. Tani komandanti suprem i forcave aleate në
7 Evropë, Gjenerali Wesley Clark, ka vizituar Brigadën
8 Shumëkombëshe Lindje më datën 1 gusht. A jeni takuar me të atë
9 ditë?

10 PË. Jo, nuk jam takuar. Më është kërkuar nga komandanti që të
11 siguroj që shumë zona në sektor të ishin të sigurta për
12 udhëtimin e tij të sigurt.

13 PY. A dini ju me kë është takuar atë ditë?

14 PË. E di që komandanti im është takuar me të dhe të tjerë.

15 PY. Cili komandant ishte ai?

16 PË. Tani, nuk më -- dhe një herë cila ishte data?

17 PY. 1 gusht.

18 PË. Mund të ketë qenë Steven Hicks dhe Gjenerali Craddock.

19 PY. Dhe ju e dini se raportet e inteligjencës që ka marrë
20 përpara vizitës së tij Gjenerali Clark, a e dini cilat kanë
21 qenë këto?

22 PË. Gjenerali Clark?

23 PY. A keni pasur ju qasje të njëjtit raport inteligjence siç
24 Gjeneral, ato që ka marrë Gjenerali Clark?

25 PË. Jo përpara që të jetë ndarë me të tjerët. Sigurisht, më

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 88

1 vonë.

2 PY. Dua, tani do t'ju tregoj një raport që ai ka shkruar pas
3 vizitës së tij.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe referenca për këtë është
5 SPOE00217919-00218047. Kërkoj ndjesë, duhet të kalojmë në
6 seancë private ndoshta.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
8 seancë private.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 89

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 90

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit. A mund të kërkoj

23 që të pranohet ky dokument si provë?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

25 kundërshtim?

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 91

1 Z. HALLING: [Përkthim] Me sa kuptojmë bëhet fjalë për
2 këtë letrën me dy faqe dhe nuk kemi kundërshtime.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, është kjo faqja me dy
4 letra -- është kjo letra me dy faqe.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me
6 numër SPOE00218019 deri në numrin SPOE00218020, kështu?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
9 pranohet.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 këto dy faqe marrin numrin e provës materiale 1D00174. Dhe
12 klasifikimi është konfidencial.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

14 PY. Kam një pyetje tjetër për këtë temë. Flasim për periudhën
15 e mëhershme, periudhën e parë. Do ju tregoj një dokument të
16 raportit nga Departamenti i Shtetit në 1999 dhe do ju pyes
17 nëse e keni parë më përpara këtë dokument.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Bëhet fjalë për dokumentin që
19 mban numrin DHT01472 deri në DHT01473. Është një fragment që
20 është marrë nga një raport i Departamentit të Shtetit i botuar
21 në dhjetor të 1999 dhe do lutesha të shkonim në faqen 15.
22 Shkojmë tek paragrafi që fillon me "Romët", në mes të
23 paragrafit. Faleminderit.

24 PY. "Një deklaratë e 20 korrikut dënonte sulmet ndaj serbëve
25 dhe romëve dhe ky, kjo deklaratë doli nga udhëheqja e ish-UÇK-

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 92

1 së dhe konkretisht ish-udhëheqësi i UÇK-së Hashim Thaçi
2 publikisht denoncoi sulmin e 28 korrikut në Gradsko. Nuk ka
3 asnjë provë që udhëheqja e UÇK-së të ketë dirigjuar këtë
4 dhunë.”

5 A keni ju ndonjë arsye për të vënë në dyshim raportin që
6 përgatiti raporti, Departamenti i Shtetit?

7 PË. Gradsko nuk ka qenë pjesë e sektorit tonë. Raporti vërtet
8 është përgatitur nga Departamenti i Shtetit dhe nuk kam asnjë
9 arsye për ta vënë në dyshim.

10 PY. Faleminderit.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet kjo faqe.

12 Z. HALLING: [Përkthim] S’kemi kundërshtime.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
14 DHT01472 deri në DHT1437 pranohet.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kërkoni që të pranoni
16 të gjithë dokumentin apo një faqe?

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Sa faqe ka dokumenti?

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ka dy faqe.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë, të dyja faqet. Do të
20 ndihmojë për të sqaruar më shumë kontekstin.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] në rregull atëherë,
22 dokumenti me ERN DHT01472 deri në DHT01473 do të marrë numrin
23 e provës materiale 1D00175 dhe klasifikimi është publik.
24 Faleminderit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 93

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

2 PY. I keni thënë Gjykatës, Trupit Gjykues, se UÇK-ja në
3 Gjilan nuk ju ka raportua për ndonjë krim të pretenduar nga
4 ana e ushtarëve të tyre. Dhe nëse do ta kishin bërë, ju do ta
5 kishit hetuar, kështu?

6 PË. Po, do ta kishim bërë.

7 PY. Këtë do ta kishit bërë në mënyrë të paanshme dhe të
8 drejtë?

9 PË. Po ne prandaj ishim aty, ne ishim pikërisht atje në bazë
10 të Rezolutës së OKB-së 1244, për ta zbatuar pikërisht këtë
11 rezolutë, pse mund ta vini këtë në dyshim?

12 PY. Do t'ju tregoj disa gjëra që keni shkruar në bllokun
13 tuaj, në ditarin tuaj personal, më falni, të asaj kohe.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Referenca për Trupin Gjykues
15 është kjo, P01519 deri në 015831.

16 PY. Në atë gazetë, në atë ditar tuajin, e keni përshkruar
17 Isufin, komandantin e UÇK-së si një terrorist që vriste
18 njerëz. A ju kujtohet kjo?

19 PË. Cila ishte data?

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do më duhet ta shikoj.

21 Z. HALLING: [Përkthim] A nuk do të ishte më mirë që ta
22 vendosim në ekran sepse do të ishte më e lehtë kështu për
23 dëshmitarin?

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull, atëherë. Vendosim
25 në ekran materialin me numër 015831 [Sipas përkthimit]. Të

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 94

1 shohim fillimisht datën.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Kjo ka qenë në fakt në vijim të
3 disa bastisjeve që kryem ne dhe gjetëm disa dokumenta në këto
4 bastisje. Unë -- ne ishim vërtetë të shqetësuar, kisha
5 përshtypjen që ata s'po ishin të sigurtë me ne dhe ishin më
6 shumë të fokusuar tek shpagimi.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

8 PY. Dhe këtë e keni shkruar në ditar. Në ditarin tuaj --

9 PË. Po, po. Por doja të dija dokumentin për të kuptuar nga e
10 bazova këtë dhe e kisha bazuar në bastisjet që kishin kryer.
11 Ndërsa dokumentacioni dhe provat pastaj u përdorën më vonë.

12 PY. Në rregull.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani do të shohim dokumentin
14 P01509.2, faqja 20.

15 PY. Në intervistë ZPS-së ia keni përshkruar shqiptarët si një
16 turmë që vrisnin njerëz, prisnin fytyrë.

17 PË. Ma jepni më të qartë, ju lutem.

18 PY. Po. Ju u keni shpjeguar se jeni përpjekur që të dyja
19 palët të vinin në një takim dhe ju keni thënë "palët thanë,
20 duhet të respektonin vullnetin e mirë të Shteteve të

21 Bashkuara, të NATO-s dhe ju keni thënë që ata ishin një grup
22 personash që ju, prisnin fytyrë", kështu?

23 PË. Po, në fakt unë kam dashur ta bëj të qartë të paktën se
24 si perceptoheshin shqiptarët prej tyre. Unë i respektoja shumë
25 personat që po vuanin, përshirë këtu shqiptarët dhe personat

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 95

1 që unë personalisht isha përpjekur të ndihmoja.

2 PY. Ka një fotografi.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Që mund ta shohim mbase edhe në
4 ekran. Ka numrin P01522 në faqen 106092.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, përsërisni
6 dhe një herë numrin e faqes sepse nuk po e gjejmë dot
7 dokumentin me numër 106092. Përfundon me 106 dokumenti që kemi
8 ne, kjo është faqja e fundit.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po përpiqem ta gjej.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Për t'ju sqaruar, jo të gjitha
11 fotot që janë lidhur me këtë dëshmitar janë të pranuar në
12 listën e materialeve. Nuk janë të gjitha, pra, të pranuar.
13 Kjo foto është një provë materiale që nuk është pranuar dhe që
14 mund të gjendet në dokumentin që fillon me faqen 105816.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

16 PY. Në titull shohim emrin e një personi, dhe këtu është
17 shkruar sikur është, këtu është një "huligan i UÇK-së", thuhet
18 këtu. Kështu është përshkruar?

19 PË. Ne kemi parë një grup të madh të ushtarëve të UÇK-së në
20 një ndeshje futbolli edhe fotografinë e kemi bërë, ka të
21 ngjarë atë ditë, s'e kam bërë unë, por e kanë bërë forcat
22 tona, këtij personi.

23 PY. Edhe një herë, në ditar keni shkruar një letër, mendoj se
24 ia keni dërguar personave në vendin tuaj. Referenca është
25 P01519 deri në 105835. Dhe aty i jeni drejtuar Kosovës si një

1 vend që e ka harruar Zoti, kështu? Pra, ju mendoni se duke e
2 përshkruar kështu Kosovën jeni i paanshëm?

3 PË. Është kollaj tani t'i interpretosh gjërat si të duash.
4 Këtë fotografi as nuk e kam emërtuar unë, as nuk e kam
5 trajtuar këtë. Mua më kujtohet situata kur është fotografuar
6 ky person, por emërtimin e fotografisë nuk e kam bërë unë.

7 Sa i takon kësaj deklaratës, që kur thua nga pikëpamja
8 gjeografike është një vend i harruar nga Zoti, sigurisht që
9 situata atëherë ishte e zyrtë, kishte vrasje, dhe pikëpamja
10 ime ishte personale, ishte që ata që po vuanin më shumë ishin
11 -- merrnin më pak kujdes se të tjerët. Dhe në fakt bëhej fjalë
12 për popullatën rome, ata s'përmenden pothuajse fare, për ata
13 na vinte keq.

14 Ne donim që të shkonim atje dhe të gjenim kush ishin
15 kryesit dhe t'i ndalonim.

16 PY. Më falni, dua që të fokusohemi se s'kemi kohë.

17 PË. Po thoni që unë paragjykoj shqiptarët? Nëse po thoni
18 këtë, jo, nuk është kështu.

19 PY. Të flasim tani për fjalimin e Hashim Thaçit.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Fillimisht heqim dokumentin nga
21 ekrani.

22 PY. Më 3 tetor 1999, ju keni ofruar sigurinë, shërbimin e
23 sigurisë gjatë kohës që mbajti fjalimin z. Thaçi në Gjilan. E
24 dini ju që ai atje në fakt shpalli dhe formimin e partisë së
25 tij politike?

1 PË. E dija që ishte përfshirë në një proces politik, prandaj
2 dhe për këtë arsye kishim edhe urdhër që t'i ofronim shërbimin
3 e sigurisë.

4 PY. Tani, ju jeni mbështetur tek përkthyesit për ta kuptuar
5 fjalimin, sepse ju nuk e njihnit mirë gjuhën shqipe, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. A pajtoheni që, në përgjithësi, kur komunikoni me
8 shqiptarët në Kosovë ju përdornit përkthyesit?

9 PË. Po. Por duhet të kuptoni që në terren ne kishim qasje në
10 përkthyes të Kategorisë 3. Këta ishin shtetas, këta ishin
11 banorë të Shteteve të Bashkuara që mund të merreshin me
12 informacione të klasifikuara dhe që ishin persona vërtetë të
13 besueshëm.

14 PY. Këta që thoni ju që ishin të Shteteve të Bashkuara, ishin
15 nga Kosova apo nga Shqipëria?

16 PË. Nuk e di rast pas rasti ku e kishin mësuar gjuhën, a e
17 kishin mësuar prej familjes të tyre se ishin brezi i dytë i
18 tyre apo kishin lindur atje. Ndonjëherë njiheshim edhe më
19 afër, por e di që ishin shtetas të Shteteve të Bashkuara dhe
20 që ishin betuar për t'i qëndruar besnikë vendit tonë.

21 PY. Faleminderit. I keni thënë ZPS-së që ju përpiqeshit të
22 monitoroni ose të vërenit me kujdes atë që thonin udhëheqësit
23 sepse krijoni një përshtypje për synimin që kishin ata,
24 kështu?

25 PË. Po. Në fakt, rregullisht ne kishim, kishim pak përkthyes

1 dhe duhet të vendosnim shumë shpejt se ku do të shkonim dhe
2 ndonjëherë përkthyesit më të mirë i kishim me komandantë të
3 tjerë. Atë ditë, komandanti Scurlock më dha përkthyesin më të
4 mirë në mënyrë që unë të kuptoja se çfarë po ndodhte në këtë
5 rast, kështu që jo vetëm më ofruan, nuk ofruam vetëm shërbimin
6 e sigurisë, por kishim për detyrë të dëgjonim edhe çfarë
7 deklarate po bëhej, se çfarë strategjie politike do të kishin
8 personat që donin të merrnin pushtetin.

9 PY. Në rregull. Ju këtë e keni në fakt e keni hedhur në një
10 shënim e ne do ta shikojmë këtë në ekran.

11 PË. Në rregull.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] është dokumenti me numër P01518
13 në faqen 105939. Paragrafi 3.

14 PY. Ju këtu keni thënë kështu:

15 "Presidenti i vetëshpallur i Kosovës, z. Thaçi shkoi në
16 Gjilan si TF 1-26 IN -- grupi TF 1-26 IN rrethoi zonën për të
17 parandaluar ndonjë akt dhune atje. Fjalimi i Thaçit ishte si
18 armiqësor dhe ishte një kundërshtim me objektivat që kishte
19 deklaruar OKB-ja dhe ai tha që ishte nevoja që Kosova të
20 kujdesej për serbët që kishin mbetur aty dhe të ishte vërtet -
21 - Kosova do të largonte serbët që kishin ngelur aty dhe të
22 ishte vërtet përfundimisht e lirë."

23 Në të njëjtën ditë ju keni thënë kështu për Thaçin:

24 "Ai foli për idealet e tij të forta dhe tha që Kosova nuk
25 ishte ende tërësisht e bashkuar sepse në atë kishte ende

1 serbë. Thaçi po ashtu tha se Presheva ishte ende pjesë e
2 Kosovës", dhe unë i thashë, dhe në thonjëza i thashë 'që nuk
3 ishin' 'dhe se do të mbroheshin'".

4 Tani, kur iu bëri pyetje Prokuroria për këto deklaratat,
5 ju thatë që nga pikëpamja historike kjo që shohim në ekran
6 është e saktë, për këtë s'mund të bënit komente dhe nuk mund
7 të thonit atje diçka që jepte mesazhin e gabuar, se kjo do të
8 ishte e rrezikshme. Kështu?

9 PË. Do të bëjmë një ndarje të qartë mes informacioneve që
10 vendos në të dhëna, në dokumentacion historik, dhe se çfarë
11 hedh në bllokun tënd personal. Unë nuk mund të them që kanë
12 qenë të pasakta, por varet se si interpreton secilën prej
13 tyre.

14 PY. Në intervistën tuaj, ZPS-ja ju ka treguar një memo të
15 UNMIK-ut për të njëjtin fjalim. Dhe për procesverbal dokumenti
16 është SITF00173046 deri në 00173046. Këtu është një folës
17 tjetër që është identifikuar si Hyseni, që ka thënë:

18 "Dua një Kosovë pa serbët dhe tashmë -- donim një Kosovë
19 pa serbët dhe tashmë e kemi."

20 Dhe ju bënë pyetje për këtë, ju, si ju kujtohej ju kjo
21 gjë. Ju thatë që ajo që keni shkruar është e saktë dhe s'dije
22 si ta shpjegoje ndryshe.

23 PË. Nëse më pyet për dallimin mes ditarit tim personal,
24 dokumentacionit historik, po jua jap përgjigjen tani. Më ishin
25 dhënë direktiva të qarta të dëgjoja fjalimin e z. Thaçi. Këtë

1 e bëra, bëra disa shënime për komentet e tij. Kur thashë që
2 mund të bien ndesh me Rezolutën 1244, dhe konkretisht bëhej
3 fjalë për çdo gjë që mund të binte në kundërshtim për të pasur
4 një Kosovë multietnike dhe për të larguar popullata të
5 shqiptarëve që nuk ishin -- dhe për të përfshirë, dhe për të
6 përfshirë në Kosovë popullata shqiptare që në fakt nuk ishin
7 pjesë e Kosovës, siç ishte Lugina e Preshevës.
8 PY. Në fakt i keni thënë ZPS-së që cilido të jetë ky dallim,
9 ishte e qartë që Thaçi nuk donte një Kosovë shumetnike.
10 PË. Ky ishte interpretimi ynë.
11 PY. Dhe se serbët nuk ishin të mikpritur dhe kjo ishte
12 komunikuar nga udhëheqësit, udhëheqësi i tyre.
13 PË. Udhëheqësit në shumës.
14 PY. Tani, si e interpretuat ju, ku e dëgjuat ju që ta ketë
15 thënë këtë z. Thaçi se si e konceptonte ai UÇK-në?
16 PË. Ne UÇK-në e konsideronim një organ që duhej të mos
17 ekzistonte më pas 20 shtatorit që, në fakt, ishte 90 ditëshi
18 sipas Marrëveshjes Teknike.
19 PY. Në fakt duhet të jam pak më konkrete unë në pyetjen time.
20 Te ky fjalimi po thoja unë, që dëgjuat z. Thaçi të thoshte
21 këto gjëra, si ndikoni në mendimin, në përshtypjen tuaj për
22 UÇK-në? Mos shkoni përtej kësaj, ju lutem.
23 PË. Fjalimet i dëgjonim sepse ne duhet të raportonim ato që
24 thuheshin, për të kuptuar çfarë objektivash mund të kishin
25 personat që do të drejtonin atë komb. Sa i takon UÇK-së dhe

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 101

1 Task Forcës 126, për mua opinionet ishte, opinionin ishte që
2 nuk po respektonin Marrëveshjen Teknike, po krijonin --
3 PY. Do t'ju ndërpres, ju lutem. Ky fjalim, fjalimi konkret.
4 PË. Po jap mendimin tim, unë po ju them që UÇK-ja nuk po
5 respektonte Marrëveshjen Teknike. Nuk po fokusohesha në një
6 fjalim të vetëm të udhëheqësit politik që kishte shkuar për
7 një vizitë në Gjilan.

8 PY. Në rregull. E dini ju që është incizuar ky fjalim nga një
9 televizion në atë kohë?

10 PË. Nuk e dija këtë.

11 PY. Në rregull. Atëherë do jua tregoj unë këtë fjalim. Ta
12 shohim në një video. Videoja në fakt është 20 minuta. Do të
13 propozoja që të dëgjonim vetëm pjesën ku flet Hashim Thaçi dhe
14 mbase pak kur flet edhe Hyseni. Por nuk e di preferoni ta
15 bëjmë përpara apo pas pushimit të drekës? Në fakt duhet të
16 fillojmë me fjalimin e Thaçit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
18 atëherë, fillojmë me pjesën ku flet z. Thaçi dhe pjesën tjetër
19 ta dëgjojmë pas pushimit.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit. Në rregull.
21 Shohim dokumentin, ka numër DHT04076 dhe fillon në minutën
22 9:54 dhe duhet ta shohim deri tek minuta 21:16. Është me
23 titra, i kemi vendosur titra ne, dhe e kemi dhe transkriptin
24 përkatës. Dhe për procesverbal është DHT04076-4081.
25 Transkripti i ka të gjitha fjalimet.

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 102

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 S'është më mirë në fakt ta bëjmë pas pushimit të drekës që ta
3 bëni organizimin siç kishit planifikuar fillimisht?

4 E bëjmë tani pushimin e drekës në mënyrë që të dyja
5 fjalimet t'i shohim bashkë me njëri-tjetrin.

6 Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit. Faleminderit.

7 Ju lutem, mos e diskutoni dëshminë tuaj me askënd jashtë
8 sallës së gjyqit.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe sa kohë
12 keni menduar?

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mendoj, unë kam dhe gjysmë ore,
14 por do kërkoja dhe 15 minuta më shumë. Në fakt, koordinova me
15 avokatin tjetër, z. Ellis, dhe atij nuk do t'i nevojiten të
16 dyja orët që kishte kërkuar fillimisht, kështu që besoj se për
17 45 minuta unë do të përfundoj.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59.

20 --- Seanca rifillon në orën 14.31

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, një çështje
22 të vogël përpara sesa të vijojmë më tej.

23 Me ndihmën e tabelës që iu dha nga Sekretarja e seancës,
24 ne vumë re që mbi bazën e asaj çfarë na u dha gjatë pushimit
25 të drekës se të gjitha faqet e përkthyer të P1532 dhe P1531

1 janë shënuar për pranim dhe thjesht donim që të konfirmonim që
2 të gjithë këto faqe të përkthyer janë po ashtu pjesë e
3 materialeve të pranuar si prova.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thuaje dhe
5 një herë?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Më konkretisht, të dy fotografitë,
7 të gamat e fotografive, domethënë, prova P1522 dhe përkthimi
8 në anglisht që janë faqet 106007 deri në 106009 dhe po ashtu
9 106016.

10 Ju kërkoj ndjesë. Edhe një herë. 106016 deri në 106016.
11 Atëherë sa i takon provës P1531, janë dy faqe që kanë
12 transkriptet në anglisht veçmas, që janë faqet 106077 dhe
13 106080. Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
15 kundërshtim lidhur me këtë? Nuk ka kundërshtim? Atëherë do
16 bëhet dhe kjo shtesë që u sqarua nga z. Halling.

17 Znj. Sekretare, mund të vazhdoni. Dhe një herë në provën
18 1522, faqja 106007 dhe 106009 dhe 106016 deri në 106016.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, të nderuar
20 Gjykatës. Këto përkthimet që u cituan më sipër do të shtohen
21 në provën gjyqësore 1522.

22 Ju kërkoj ndjesë, është prova 1522.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova
24 gjyqësore P131, faqja 106077 dhe 106080 shtohen në këtë provë.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, të nderuar

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 104

1 Gjykatës. Përkthimi do të shtohet në provën P01531.

2 Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Znj. Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

7 uleni, Dëshmitar.

8 Do të vazhdojmë me kundërpjetjet e Mbrojtjes së z. Thaçi.

9 Znj. Tavakoli, mund të vazhdoni.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

11 Sikurse e përmenda, kemi marrë një kopje të fjalimeve nga

12 transmetuesi shqiptar, do të transmetojmë fjalimin e z. Thaçi.

13 PY. Do ta ndalojmë videon në momentin kur tregohet që Hashim

14 Thaçi thotë që Kosova duhet që të largojë pjesën e mbetur të

15 serbëve për të qenë e lirë dhe ku thuhet që Kosova multietnike

16 është e padëshirueshme.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju lutem, ngrini dorën në

18 momentin kur ta shikoni këtë.

19 [Luhet videoincizimi]

20 [Zëri] "Të nderuar qytetarë të Gjilanit e rrethinë. Të

21 nderuar qytetarë të Gjilanit e rrethinës, të nderuar eprorë

22 dhe ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuara

23 familje të dëshmorëve të kombit. Kam nderin që të sot të jem

24 prezent në këtë manifestim gjithëpopullor. Manifestimin e parë

25 në liri të plotë të qytetit të Gjilanit e të Kosovës.

1 "Organizimi i këtij manifestimi pikërisht në qendër të
2 qytetit është shumë domethënës sepse liria e Kosovës, liria e
3 Kosovës, liria e cila është prezente edhe në qytetin e
4 Gjilanit është pikërisht në zemrën e qytetit dhe është
5 pikërisht në zemrat tuaj dhe kjo do ta mbrojë. Ne, të trevave
6 tjera të Kosovës, gjithmonë kemi qenë krenar me djemtë dhe
7 vashat e Gjilanit sepse ata kanë dhënë dhe janë duke dhënë një
8 kontribut të jashtëzakonisht të çmueshëm në lëvizjen tonë për
9 çlirimin e Kosovës.

10 "Ju ishit ata që në vitin 1968, që në vitin 1981, i dhatë
11 grushtin më të rëndë regjimit titist, regjimit të
12 Jugosllavisë.

13 "Prandaj edhe pse sot fizikisht në mesin tonë nuk janë
14 dëshmorët e kombit Kadri Zeka, Metush Krasniqi, Rexhep Mala,
15 Nuhi Berisha, ata janë sot këtu, ata janë në mesin tonë sepse
16 ranë për lirinë e Kosovës. Për këtë liri.

17 "Ju që nga themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
18 keni dhënë një kontribut jashtëzakonisht të çmueshëm në
19 mobilizimin, masivizimin dhe fuqizimin e saj në të gjithë
20 Kosovën.

21 "Unë jam takuar me shumë bashkëluftëtarë nga zona
22 operative e Karadakut që ka vepruar e luftuar në tërë Kosovën,
23 po ashtu siç kanë vepruar dhe u ndërmorën edhe në zonat e
24 Karadakut bashkëluftëtarë nga trevat të tjera të Kosovës.

25 "Dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte ajo që bashkoi

1 popullin, ishte ajo që me të vërtetë kthej respektin, kthej
2 simpatinë, kthej mbështetjen e fuqishme të bashkësisë
3 ndërkombëtare për liri e demokraci në Kosovë.

4 "Kur filloi lufta në Drenicë, aty kam pa shumë djem e
5 vasha nga Gjilani. Ata ishin në Likovc, ata ishin në Prekaz,
6 ata ishin tek komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të
7 Kosovës Adem Jashari.

8 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi për këtë ditë.
9 Ushtria Çlirimtare e Kosovës është çliruese e Kosovës.

10 "Pa ajo është ajo e cila solli NATO-n në Kosovë, ajo e
11 cila e fitoi simpatinë, e fitoi respektin, e fitoi mbështetjen
12 e fuqishme politike, morale, humanitare dhe ushtarake dhe
13 është fakt.

14 "Dhe ky është kapitali më i madh që kemi pasur në
15 historinë e popullit shqiptar ndonjëherë, sepse e kemi
16 mbështetjen e fortë të bashkësisë ndërkombëtare.

17 "Duke ju përgjigjur realitetit të ri të krijuar në Kosovë
18 dhe rajon pas dëbimit të trupave ushtarake-policore serbe nga
19 Kosova edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës i ka hyrë, siç i ka
20 hyrë një transformimi të gjithë mbarshëm shoqëror, Kosova i
21 hyri transformimit të saj. Ajo edhe pse sot nuk është me
22 emblemën Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ajo është transformuar
23 në Trupa Mbrojtëse të Kosovës në forcë mbrojtëse të Kosovës.

24 "Mbrojtëse të Kosovës do të udhëhiqen nga struktura ish-
25 udhëheqëse të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe në nivel të

1 Shtabit të Përgjithshëm edhe në nivel zone operative të
2 Kosovës. Ajo do t'i ketë mbi 5.000 ushtarë të ish-Ushtrisë
3 Çlirimtare të Kosovës në këtë forcë mbrojtëse. Po ajo do të
4 ketë gjashtë zona operative të cilat do të funksionojnë dhe
5 operojnë në Kosovë. Ajo do ta ketë në kuadër të saj edhe
6 nderin dhe krenarinë kombëtare Gardën e Kosovës.

7 "Po ashtu, në kuadër të transformimit dhe
8 profesionalizimit të strukturave mbrojtëse të Kosovës, ne së
9 shpejti do të hapim edhe Akademinë Ushtarake e cila do të
10 nxjerrë eprorët ushtarakë dhe profesionistë për të ardhmen e
11 cila do të jetë garant për ushtrinë e Kosovës.

12 "E cila është veç hapat e parë të hapjes në Vushtri.

13 "Ne do të ndërtojmë edhe policinë tonë. Një polici
14 moderne, një polici demokratike, një polici e cila kurrë nuk
15 do të bëjë krime mbi popull e siç kanë bë disa të tjerë me ne.

16 "Po ajo do jetë e përbërë -- ajo polici do jetë e përbërë
17 60 për qind nga ish-strukturat e policisë ushtarake të
18 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në të nuk do të ketë vend as
19 për kriminelë, as për vrasës dhe as për njerëz që kanë
20 arrestuar e torturuar djemtë dhe vëllezërit tanë, krimet e
21 luftës.

22 "Megjithatë nuk mund të jemi plotësisht të kënaqur me
23 situatën e cila është në Kosovë.

24 "Ju e dini në qytetin e Mitrovicës gjendja nuk është
25 aspak e mirë. Aty faktikisht kemi një ndarje të qytetit, një

1 ndarje që është duke na preokupuar dhe jemi duke bërë çmos që
2 në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare këtë ndarje ta
3 thejmë dhe ura e cila ka qenë urë lidhëse, ura e Ibrit të jetë
4 urë e afrimit, e bashkimit të qyteteve.

5 "Të interesuar që ta gjejmë një zgjidhje politike rreth
6 këtij problemi. Por, territori i Kosovës njihet dhe garantohet
7 ndërkombëtarisht. Forca mbrojtëse e Kosovë e ka për obligim, e
8 ka për përgjegjësi dhe këtë obligim dhe përgjegjësi do ta
9 kryejë. Po ajo do ta mbrojë çdo pëllëmbë të territorit të
10 Kosovës edhe Mitrovicën.

11 "Ne kemi mbështetë dhe mbështesim qytetarit e Rahovecit
12 në zgjidhje të mirë, me zgjidhje të drejtë dhe një zgjidhje që
13 do jetë -- në të cilën do të jenë prezentë trupat
14 ndërkombëtare, policore e jo trupat ushtarake ruse, ata të
15 cilët kanë bërë krime, masakra në popullatën e Rahovecit.

16 "Mjaft ekskluzive edhe në Preshevë e Medvegje e Bujanovc.
17 Shpërnguljet e qytetarëve të Preshevës, Medvegjes dhe
18 Bujanovcit, dëbimi me dhunë, arrestimet, burgosjet, torturat
19 dhe largimi i këtyre qytetarëve për në Gjilan e në vise të
20 tjera brenda në Kosovë është një dukuri që me të vërtetë nuk
21 duhet toleruar. Qytetarët e këtyre viseve shqiptare kanë të
22 drejtë të jetojnë aty sepse ata janë autoktonë dhe do të
23 jetojnë aty.

24 "Ne nuk do të lejojmë që ata të largohen nga atje dhe ne
25 t'i presim këtu. Ne duhet t'u ndihmojmë që ata të jetojnë atje

1 dhe do të jetojnë.

2 "Në çështjen tonë kombëtare, ne dhe në vizitën e fundit
3 të cilën e kishim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kemi
4 ngritur këtë çështje në instancat më të larta edhe në *State*
5 *Department* edhe në Pentagon, por edhe në Shtëpinë e Bardhë.
6 Dhe jam i bindur se do ta kemi një zgjidhje të drejtë, një
7 zgjidhje politike. Por, megjithatë, ne do jemi këtu dhe do t'i
8 përgjigjemi situatave të rrezikshme të cilat mund të vijnë dhe
9 mund të pasojnë edhe më vonë.

10 "Qyteti juaj është duke rilindur, siç është duke rilindur
11 e tërë Kosova.

12 "Sot kemi obligime dhe ne si Qeveri e Përkohshme e
13 Kosovës brenda mundësive, potencialeve dhe përgjegjësive të
14 cilat i kemi, do t'i kryejmë këto obligime për këtë rilindje
15 të Kosovës. Ne jemi të interesuar dhe do ta bëjmë një
16 transformim të gjithmbarshëm të Kosovës.

17 "Po ashtu ne do të bëjmë çmos që së shpejti të fillojmë
18 rindërtimin e shtëpive të djegura gjatë luftës dhe rindërtimin
19 dhe ndërtimin e spitaleve të reja, shkollave të reja, rrugëve
20 të reja dhe do të ndërtojmë një Kosovë të re, një Kosovë të
21 lirë një Kosovë demokratike.

22 "Ne kemi bërë një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të
23 pavarësisë së plotë të Kosovës sepse pavarësinë e plotë ende
24 nuk e kemi fituar dhe kjo pavarësi do mbrohet pikërisht nga
25 ju. Sepse ne nuk do të lejojmë që askush më të vendosë për

1 Kosovën jashtë Kosove. Më për Kosovën nuk do të vendoset në
2 Beograd apo në kancelaritë e Evropës. Për Kosovën dhe rreth
3 Kosovës do të vendoset në Kosovë nëpërmes deklarimit të
4 qytetarëve dhe përmes deklarimit tuaj, nëpërmes të drejtës
5 universale dhe përmes të drejtës për referendum dhe ju të
6 gjithë kam besim të plotë se do të deklaroheni për të drejtën
7 e pavarësisë.

8 "Faleminderit."

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

10 PY. Z. Russell, Hashim Thaçi nuk ka thënë atë çfarë keni
11 thënë ju, apo jo?

12 Ju kërkojmë ndjesë se kishte mbivendosje përkthimi.

13 Besoj se e dëgjuat tani fjalimin dhe nuk më ndaluar në asnjë
14 vend. Hashim Thaçi nuk ka thënë atë çfarë pretendoni ju që se
15 ka thanë ai se ju keni thënë që ai ka thënë, pra, Hashim Thaçi
16 ka thënë që nuk dëshironte që të kishte një Kosovë
17 multietnike, apo jo?

18 PË. Jo, ekzaktësisht e formuluar kështu ndoshta. Por mendoj
19 që pjesa lidhur me Mitrovicën që dëgjova unë mund të
20 interpretohet në atë mënyrë. Më pas komentet për Preshevën,
21 për Luginën e Preshevës që ata duhet të ishin të lirë që të
22 vetëvendosnin besoj që do më çonin mua të bëja të njëjtat
23 komente që kam bërë dhe më përpara sa i takon këtyre pjesëve,
24 këtyre zonave

25 PY. Nuk e jam e qartë lidhur me atë çfarë thatë. Lidhur me

1 Mitrovicën ...

2 PË. Besoj që është nga fundi i faqes 5.

3 PY. Po. Lidhur me Mitrovicën ajo çfarë ka thënë në transkript
4 që:

5 "Ka një ndarje *de facto* të qytetit atje, një ndarje që na
6 shqetëson, kështu që ne po bëjmë më të mirën tonë që ta
7 ndërpresim këtë ndarje në bashkëpunim me komunitetin
8 ndërkombëtar, ka pasur një urë, ura e Ibrit dhe ne do të
9 punojmë që kjo urë të jetë urë lidhëse, një urë që i bashkon
10 qytetet."

11 A është kjo pjesa, kjo pjesa që ju thoni që ai nuk po
12 parashikonte një Kosovë multietnike? Me këtë e lidhni komentin
13 tuaj?

14 PË. Mendoj, ose të paktën mënyra sesi e kemi kuptuar ne,
15 ekzistonte, pra, pjesa e serbëve në Mitrovicë dhe duhej që të
16 zgjidhej, le të themi, dallimi ose ndarja që ekzistonte atje
17 pavarësisht sesi mund të interpretohet kjo.

18 PY. Tani që jemi të qartë për atë lidhur me atë çfarë thatë
19 ju, z. Russell.

20 PË. Në rregull.

21 PY. Tani sa i takon analizës historike që ju mendoni që është
22 e saktë, ju thoni si më poshtë:

23 "Fjalimi i Thaçit ishte armiqësor dhe ishte kundër
24 multietnicitetit ..."

25 Nuk e di tani se për çfarë e keni fjalën? A mund të na

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 112

1 thoni në fakt se nga e keni nxjerrë këtë përfundim të tuajin
2 sa i takon këtij fjalimi të z. Thaçi?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Për të qenë të drejtë me
4 dëshmitarin, fjalia u ndërpre, domethënë, nuk u tha e plotë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta thoni
6 dhe një herë?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ka dy pika këtu.

8 PY. Atëhere së pari citohet:

9 "... nevoja për serbët për të qenë vërtetë të lirë ..."

10 PË. Nuk e kuptova pyetjen.

11 PY. Pyetja është kjo: I keni thënë ZPS-së dhe e keni
12 përmendur shumë herë këtë përfshirë dhe javën që shkoi në
13 seancën përgatitore se në fjalimin që transmetuam ishte e
14 qartë se Hashim Thaçi nuk parashikonte një Kosovë multietnike
15 dhe se ai ka dhënë një tregues ose ka thënë që serbët nuk
16 ishin të mirëpritur dhe ky është një citim i drejtpërdrejt në
17 fakt nga intervista e dytë që keni dhënë për ZPS-në. Dhe po
18 ashtu në analizën historike ju keni thënë që keni cituar
19 nevojën që të çlirohej Kosova nga pjesa tjetër e serbëve në
20 mënyrë që Kosova të konsiderohej tërësisht e lirë.

21 Tani, z. Russell, juve e dëgjuat, apo jo, fjalimin.

22 Asgjëkundi z. Thaçi nuk thotë gjërat që pretendoni që ka
23 thënë, apo jo?

24 PË. Ai foli për Luginën e Preshevës dhe në ato rajone dhe
25 foli për rajonin që duhej që të vendosnin vetë për të ardhmen

1 e tyre dhe kjo ishte në kundërshtim me Rezolutën 1244.

2 PY. Do të flasim për Preshevën pak më vonë. Megjithatë pyetja
3 ime ishte kjo: Nuk ka thënë në asnjë vend z. Thaçi atë çfarë
4 pretendoni ju që ka thënë, apo jo?

5 PË. Interpretimi i Mitrovicës, ose mënyra se si e interpretoj
6 unë pjesën e lidhur me Mitrovicën, ishte që ai ka folur për
7 problemet ose shqetësimet që kanë qenë aty ose të paktën
8 interpretimi im është që serbët nuk ishin të mirëpritur aty.
9 Sa i takon kontekstit më të gjerë, mendoj që mund të
10 interpretohet fjalimi ose pjesë e fjalimit që serbët nuk ishin
11 të mirëpritur në Kosovë.

12 PY. Më falni se nuk e kapa atë çfarë thatë, doni të thoni që
13 ka pasur dhe persona të tjerë në platformë?

14 PË. Jo, me domosdoshmëri në Luginën e Preshevës, megjithatë
15 çështja është që duke pas parasysh komentet e përgjithshme që
16 i kemi dëgjuar atë ditë, unë vazhdoj të them që kam të njëjtin
17 qëndrim që e kam thënë më herët pavarësisht në qoftë se mund
18 të jetë thënë shprehimisht kjo gjë në fjalim apo jo.

19 PY. Atëhere i ndajmë pak çështjet. Domethënë Lugina e
20 Preshevës është një gjë tjetër. Kam një grup pyetjesh lidhur
21 me Luginën e Preshevës dhe atë çfarë ka thënë Hashim Thaçi
22 lidhur me Luginën e Preshevës, kështu që do ju kërkoja që të
23 mos i ngatërroni të dyja gjërat.

24 Unë kam videot e të gjitha fjalimeve që janë mbajtur atë
25 ditë dhe unë ju parashtroj se asnjë folës atë ditë nuk ka

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 114

1 folur lidhur me nevojën për të pasur një Kosovë pa serbë. Dhe
2 në qoftë se doni, mund të transmetojmë të gjithë videon. Do i
3 kërkoja Gjykatësve të më jepte leje për këtë.

4 PË. Lexoj shpejt. Kështu që nuk është e nevojshme që të
5 transmetoni videon, mund ta lexoj, mund t'i lexoj transkriptet
6 vetë në qoftë se kjo është mënyra më e thjeshtë.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Çështja është që nuk e kam
8 planifikuar gjithë këtë kohë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
10 dëshmitari dëshiron që të shikojë transkriptet e përkthimit të
11 fjalimeve, mund t'i hedhë një sy dëshmitari atyre.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull. Atëhere përkthimi
13 për Gjykatën është DHT04067-EN. Dhe në këtë dokument
14 përfshihen të gjitha fjalimet e mbajtura atë ditë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po marr
16 përkthimin ose nuk po shikoj tekstin në ekran.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

18 PY. Z. Russell, e shikoni dokumentin në ekran, përkthimin?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e shohim
20 dot sepse ka ndaluar transkripti.

21 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
22 këshillohen]

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

24 PY. Z. Russell, atëherë z. Russell na tha që dëshironte që të
25 lexonte transkriptin, domethënë, sepse thashë që do bëjë

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 115

1 pyetje të veçanta për Luginën e Preshevës. Ju i keni thënë
2 ZPS-së që folësit kanë folur lidhur me nevojën për të larguar
3 serbët nga Kosova. Kështu që do ju kërkoja, Dëshmitar, që të
4 lexonit transkriptin dhe na thoni ju lutem, se në qoftë se nuk
5 e ka thënë këtë z. Thaçi, kush folës tjetër e ka thënë këtë që
6 pretendoni ju të jetë thënë.

7 PË. A mund të kalojmë pak më poshtë në faqe?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo. Nuk e di
9 keni ndonjë version të printuar, znj. Tavakoli?

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do ishte më mirë që ta kalojmë
11 shpejt faqen.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Russell,
13 na thoni kur doni që të kalojmë më poshtë në faqe.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull. Ju lutem kaloni më
15 poshtë në faqe. Mund të vazhdoni pak më poshtë në faqe.
16 Vazhdoni pak më poshtë. Mund të vazhdoni më poshtë, ju lutem.
17 Mund të vazhdoni më poshtë.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

19 PY. Tani kalojmë përsëri tek fjalimi i Hashim Thaçit që është
20 fjalimi i fundit. Cili prej këtyre folësve ka thënë atë çfarë
21 pretendoni ju që serbët duhet të largoheshin nga Kosova?

22 PË. Nga këto fragmente nuk shikoj asnjë deklaratë të tillë.
23 Me videon duke menduar që çdo gjë ka qenë në vijimësi e
24 ndryshuar e paedituar, e paredaktuar, këtu nuk është se ka
25 ndonjë gjë që mund të bëja koment të tillë.

1 PY. Ky përkthim ose transkripti është pasqyrë e plotë e asaj
2 çfarë është thënë në fjalime, megjithatë në qoftë se doni që
3 të transmetojmë videot, mund të transmetojmë dhe videot.

4 PË. Me aq sa pashë, videoja ishte e shkurtuar diku, kështu që
5 nuk e di sesi ka qenë versioni i plotë.

6 PY. Këtë video e kemi marrë nga ofruesi, nga transmetuesi.
7 Besoj se pajtohem, Dëshmitar, që në intervistën që ju ka bërë
8 ZPS-ja ju kanë thënë, pra, Prokurori ju ka thënë që burimet e
9 tjera që ata kanë pasur nuk e kanë regjistruar Hashim Thaçi ta
10 ketë thënë këtë që pretendoni ju.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe më konkretisht kjo
12 pasqyrohet në intervistën e dytë që keni pasur me ZPS-në që
13 është tani prova gjyqësore e pranuar P01510 Pjesa 1, faqja 25.

14 PY. Aty thuhet:

15 "Tani duhet t'ju them nja dy gjëra që kemi ne. Ne kemi
16 një memo të UNMIK-ut që thotë që ka një koment në këtë fjalim
17 më datë 3 tetor që nuk kishte serbë në Kosovë, po kjo nuk
18 është thënë nga z. Thaçi po është thënë nga z. Hyseni. Po
19 ashtu kemi një video që është regjistruar nga *Associated*
20 *Press*, vetëm një pjesë e këtij fjalimi. Tek pjesa e
21 regjistruar z. Thaçi nuk flet për dëbimin e serbëve në atë
22 pjesë dhe kjo nuk është pasqyruar as nga artikulli i
23 *Associated Press*."

24 Dhe në lidhje me këtë, Prokurori ju ka treguar dokumentin
25 020858 në seancën përgatitore dhe pastaj ju bëhet pyetja se

1 cila mendoni ju që ishte dallimi.

2 Pra, ju jeni në pajtim me Prokurorinë që asnjë nga
3 burimet e tjera që ju ka treguar Prokuroria juve, nuk përmban
4 atë çfarë thoni ju. Dhe përveç kësaj dua që të shtoj një
5 tjetër burim që nuk jua ka thënë Prokuroria, burim tjetër,
6 pra, që është një artikull nga mediat vendore të Kosovës me
7 numër DHT04067-EN, artikull që është publikuar në *Koha Ditore*,
8 më duket.

9 Në qoftë se hedhim një sy faqes së parë, shohim që z.
10 Hyseni thuhet të ketë thënë. Pastaj pak më poshtë:

11 "E duam Kosovën pa flamuj pushtuesish, e duam Kosovën me
12 flamuj të lirisë siç atë që kemi sot, pa flamuj të huaj dhe
13 pushtues, qysh e duam Kosovën pa flamuj të pushtuesit dhe
14 policëve, pa dhunë, pa terror dhe ne kemi atë. E duam Kosovën
15 pa Serbi dhe kjo është, kështu e kemi."

16 Pra, shtypi kombëtar nuk e raporton z. Hyseni të ketë
17 thënë që e don Kosovën pa serbë.

18 Dhe në qoftë se kalojmë në faqen tjetër, shtypi vendor,
19 pra, ka raportuar që ai don Kosovën pa Serbi, jo pa serbë. Dhe
20 pastaj në qoftë se e shohim më tej, ju sugjeron bazuar në këtë
21 natyrisht, po e lexoj këtë faqe, se nuk ka asgjë aty që ku z.
22 Thaçi thotë që e do Kosovën pa serbë apo ndonjë gjë tjetër
23 kundër Kosovës multietnike.

24 Nëse mund ta lexoni aty, ju lutem.

25 PË. Faqen tjetër, ju lutem, ose kaloni më poshtë. Në qoftë se

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 118

1 ka më shumë, mund të lexoj më shumë.

2 PY. Kaq ishte. Pra, mendoj që është e qartë.

3 PË. Kishte deklarata aty ku flitej për një Kosovë pa Serbi
4 dhe duhet të kuptoni në kontekst të operacioneve tona në atë
5 kohë, ishte konteksti shumë më ndryshe se sot. Dhe kishim
6 garanci në nivelin tonë kombëtar --

7 PY. Nuk dua të jem e pasjellshme, po nuk jam e interesuar për
8 këtë. Ju e keni dhënë dëshmi të saktë ku keni thënë që e keni
9 dëgjuar z. Thaçi që ka thënë disa gjëjna. Unë ua lëshova
10 incizimin dhe nuk ka asgjë të tillë.

11 PË. Kosova pa Serbi do të ishte kundër marrëveshjeve --

12 PY. Pastaj u tregova dy artikuj gazetash të botuar dhe në
13 asnjërin prej tyre nuk thuhej ajo që thoni ju. Unë po ju them
14 që jeni gabim. Në qoftë se ju nuk pajtoheni me mua, ne
15 ndalojmë këtu sepse s'kemi nevojë të vazhdojmë më tej.

16 PË. Kosova pa Serbi do të ishte në shkelje të statusit në
17 bazë të të cilit kishim hyrë në Kosovë atë kohë, dhe unë për
18 rrjedhojë kam bërë shënime bazuar në atë që për të cilën ishim
19 dërguar aty, lidhur me serbët dhe lidhur me zonat jashtë
20 Kosovës. Mesa duket në këto fjalime ka gjëra shumë të ngjashme
21 me ato.

22 PY. Faleminderit. Kjo është dëshmia juaj atëherë.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do ta dorëzojë videon dhe
24 transkriptin e fjalimit dhe artikujt të gazetave vendore si
25 prova.

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 119

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na
2 jepni numrat edhe një herë? Unë kam këtu DHT0467.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] DHT0476, anglisht, për të
4 gjitha fjalimet.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 04076
6 pranohet.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Gabova. Është DHT04076 deri në
8 DHT04081.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 04076 deri në
10 040781. Është kështu?

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po. Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
13 kundërshtime?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk ka.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

16 Znj. Sekretare, jepini një numër prove.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Një sqarim, ju lutem, i
18 nderuar Gjykatës. Videoja është DHT04075. Dhe vetëm nga minuta
19 09:54 deri në 21.16? Kjo është pjesa që dëgjuam.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po. Transkriptin e kemi për
21 tërësinë. Unë do të propozoja që të dorëzohet videoja në
22 tërësi. Në qoftë se ka ndonjë kundërshtim mund të dëgjojmë
23 videon.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk ka nevojë. Ne do të donim edhe
25 ne të njëjtën video në tërësi dhe fjalimet, transkriptet në

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 120

1 tërësi.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pranojmë,
3 pra, 040763 deri në 040781.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të pranohet si
5 me numrin 1200176. Dhe klasifikimi është publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
7 tjetër për të dorëzuar?

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Artikulli i gazetës *Koha Ditore*
9 me numrin DHT04067-EN.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
11 kundërshtim?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT04067 --

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po ngatërron. Është 04067 deri
15 tek faqja në vijim DHT04068.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT04067 deri
17 në 04068 pranohet.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti në shqip dhe
19 përkthimi në anglisht do të marrë numrin e provës materiale
20 1D00177. Dhe klasifikimi është publik. Faleminderit.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]
22 PY. Dhe ju thashë që do t'ju bëja disa pyetje lidhur me
23 Luginën e Preshevës, por përpara kësaj kam disa pyetje të
24 tjera që lidhen me pyetjet paraprahe. A ishit në dijeni gjatë
25 kohës që ishit në Kosovë, se Hashim Thaçi fliste rregullisht

1 dhe shprehej rregullisht në mënyrë publike për dëshirën e tij
2 për një Kosovë multietnike dhe kundër dhunës etnike, kundër
3 serbëve dhe të tjerëve në të gjithë territorin e Kosovës?

4 PË. Kjo ishte ajo që shpresonim.

5 PY. Për shembull, a keni parë një konferencë për shtyp më 24
6 korrik 1999, pas masakrës së 14 bujqve serbë, e keni parë këtë
7 konferencë për shtyp?

8 PË. Cila ishte data?

9 PY. 24 korrik 1999.

10 PË. Ndoshta nuk kam qenë duke parë televizor atë ditë. Kam
11 qenë ndoshta në terren.

12 PY. Në rregull. Gjykata e ka këtë dokument. Nuk mendoj që
13 kemi nevojë ta dëgjojmë. Është me numër 120090.

14 Tani, kemi dëgjuar që Hashim Thaçi në atë kohë ka
15 kontaktuar, komunikuar edhe me pakica të tjera në atë kohë,
16 turq, boshnjakë, goranë duke kërkuar, duke bërë thirrje për
17 tolerancë ndëretnike dhe bashkëjetesë?

18 PË. Kështu mendoj.

19 PY. Dua thjesht t'ju tregoj tre artikuj të shkurtër lidhur me
20 këtë pikë. E para është me numër DHT04069 deri në DHT04070 dhe
21 përkthimi i tij anglisht përfundon me 71. Tani, ky është një
22 artikull ku flitet për një vizitë që Hashim Thaçi ka bërë më
23 26 shtator ka vizituar qytetin, Mamush, turk, në Prizren dhe
24 ku ai u drejtua njerëzve në një takim publik në qeverinë
25 vendore, përfaqësues të partive politike dhe intelektualë.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nëse shohim faqen e dytë.

2 Kërkoj ndjesë, në qoftë se mund të kthehemi tek faqja e parë
3 dhe në fund të kësaj faqeje.

4 PY. Dhe këtu shohim që ai duket të ketë thënë:

5 “Sot jetojmë në një Kosovë të lirë, por kemi shumë punë,
6 detyra përpara nesh - promovimi i bashkëjetesës ku mirëkuptimi
7 i tolerancës dhe respektit civil të ndërsjellët, denigrimit
8 dhe elementet denigrues dhe destabilues që kërkojnë të
9 mbjellin ndarje mes shqiptarëve dhe turqve kanë dështuar. Ju
10 keni qenë gjithmonë dhe do të vazhdoni të jeni qytetarë të
11 Kosovës. Ju do të jetoni këtu, së bashku ne do të ndërtojmë
12 një Kosovë të lirë dhe demokratike’ ...”

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
14 faqen tre.

15 PY. “Si përfundim z. Thaçi kishte një mesazh dhe thotë: ‘Nëse
16 ne respektojmë siç duhet njeri-tjetrin në mënyrë të duhur dhe
17 ndërtojmë një kulturë të respektit etnik të ndërsjellë, besoj
18 se Kosova do të jetë një shembull jo vetëm për Ballkanin por
19 për të gjithë rajonin’”.

20 A ishit në dijeni të përpjekjeve të z. Thaçi, pjekjeve të
21 tilla të z. Thaçi?

22 PË. Kjo nuk ka qenë në zonën tonë. Ne kemi dëgjuar raportet
23 e lajmeve, kemi monitoruar aktivitetin politik për aq sa kemi
24 patur mundësi.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Ne --

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 123

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do të dorëzoja këtë si provë.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari sapo tha që nuk ka
3 asnjë dijeni për këtë. Dhe baza për të kërkuar pranimin e
4 kësaj në këtë kohë nuk qëndron.

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Që të jemi të qartë nuk kam,
6 nuk thashë që po kërkoj ta bëj këtë gjë, ta kërkoj pranimin e
7 këtij artikulli si provë për të diskretituar dëshmitarin.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimet
9 rrëzohet. DHT04069 deri në DHT04070 me përkthimin në anglisht
10 pranohet.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti dhe përkthimi
12 në anglisht do të marrë numrin e provës 1D00178. Klasifikimi
13 është publik. Faleminderit.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Artikulli i dytë që do të doja
15 të shfaqim është DHT04072 deri në DHT04072. Kjo është në
16 shqip. Dhe anglisht mendoj që vazhdon deri në 75, dy shifrat e
17 fundit. Në qoftë se mund të shohim më poshtë, të qëndrojmë në
18 faqen e parë që ë kemi kontekstin, pra, këtu është Hashim
19 Thaçi që i bën një vizitë komunitetit boshnjak në Pejë bashkë
20 me Bernard Kouchner më 5 tetor.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shohim më
22 poshtë tani në faqen vijuese. Këtu. Kjo është.

23 PY. Në krye të faqes, Hashim Thaçi raportohet të ketë thënë:

24 "Jemi të vetëdijshëm për vështirësitë që komunitetet
25 etnike të Kosovës të cilët kanë jetuar së bashku për vite të

1 tëra, vështirësitë që ata po kalojnë' kështu tha
2 administratori i misionit civil të Kombeve të Bashkuara në
3 Kosovë Bernard Kouchner, duke shtuar se 'Thaçi i ka thënë që
4 njerëzit që kanë kryer krime kundër popullatës civile dhe nuk
5 kanë vend këtu, por serbët duhet të kthehen dhe të jetojmë së
6 bashku' "

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
8 faqen tjetër.

9 PY. "Si përfundim, kryeministri Thaçi iu drejtua turmës duke
10 thënë në emër të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe në
11 emrin tim, dua t'ju përshëndes qytetarë të Vitisë, të
12 Vitomericës, të komuniteteve shqiptare dhe boshnjake. Jam i
13 gëzuar, i lumtur që ju shoh së bashku këtu."

14 Dhe paragrafi i fundit thotë.

15 "Thaçi vazhdoi më tej duke u premtuar pjesëtarëve,
16 anëtarëve të komunitetit boshnjak se ju duhet të jeni në
17 shkolla dhe do të merrni pjesë në zgjedhjet e lira që do të
18 organizojmë së shpejti. Së bashku do të bëjmë gjithçka që
19 është e mundur për të ndërtuar një Kosovë të lirë dhe shpresoj
20 që ju gjithashtu t'i bashkoheni Trupave Mbrojtëse të Kosovës
21 sepse ky Trup Mbrojtës i Kosovës nuk do të jetë vetëm i
22 shqiptarëve po i gjithë atyre që duan të jetojnë në Kosovë."

23 E dëgjuat këtë?

24 PË. Nuk kemi monitoruar fjalimet politike të z. Thaçi.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit. Do të doja që ta

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 125

1 dorëzoj këtë si provë, ju lutem, për diskreditim të
2 dëshmitarit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se kufizohet vetëm për
4 këtë arsye, atëherë nuk kemi kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT04072 deri
6 në DHT04075. A e zgjate deri në 75?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është 74. Është gabim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, DHT04074
9 pranohet.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe ky është dokumenti i fundit
11 që kishim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prisni një
13 çast. Duhet të na japë një numër.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në qoftë se e kuptova
15 siç duhet përkthimi në anglisht është nga DHT04072-DHT04074.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Versioni origjinal në
19 shqip është DHT04072 deri në DHT04072.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
22 e provës materiale 1D00179.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit. Dhe dokumenti
24 përfundimtar është i shkurtër. Shumë i shkurtër. Nuk duhet t'i
25 tregohet publikut për shkak të detyrimeve ndaj personit që e

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 126

1 ka dhënë këtë dokument apo burimit. Dhe është dokumenti
2 7007158 deri 7007167, faqja 2.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Duke parë dokumentin dhe mënyrën
4 sesi është trajtuar, ky duhet të trajtohet dhe të diskutohet
5 në seancë private.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë
7 private.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
9 Sekretare, na kaloni në seancë private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

13 PY. Kam një temë të fundit dhe do përpiqem të jem e shkurtër.

14 Kthehemi tek fjalimi i mëparshëm pra. Ju keni shënuar në

15 vlerësimin vjetor historik që Hashim Thaçi ju ka kërkuar

16 shqiptarëve që të luftojnë për liri në Luginën e Preshevës në

17 Serbi. Ju kujtohet kjo?

18 PË. Po.

19 PY. Mendoj që duke dhënë dëshmi ju thatë që ai tha se ata

20 duhet të vendosin vetë, vetëvendosje.

21 PË. Mendoj që bazuar në atë që u paraqit sot ai thotë se ata

22 duhet të jenë gati të bëjnë atë që duhet bërë, gjithçka që

23 duhet bërë dhe kjo ishte shqetësuese për ne në atë kohë.

24 PY. Nuk do t'i përsërisë atë që kemi thënë, sepse kemi

25 pikëpamje qartësisht të ndryshme nga njëri-tjetri bazuar në

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 128

1 përkthimin se ç'a ishte aty. Ajo që po ju them është që thjesht
2 në asnjë moment Hashim Thaçi në fjalimin e tij apo duke e parë
3 kur keni transkript apo në ato artikuj apo raportet e shtypit
4 nuk ka barë thirrje shqiptarëve që të marrin armë dhe të
5 luftojnë për liri në Luginën e Preshevës, apo jo?

6 PË. Nuk besoj se kam thënë ndonjëherë që ata duhet të
7 luftonin për liri në Luginën e Preshevës. Nuk jam i sigurtë
8 kujt po i referoheni, zonjë.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
10 ekran vlerësimin, raportin historik, dhe faqja konkrete të
11 cilës i referohem është kjo prova P01518 dhe faqja është
12 105939. Në qoftë se mund të shkojmë më poshtë.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] E shoh. E shoh. Po flisni lidhur
14 me Luginën e Preshevës.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

16 PY. E shihni pjesën? Ku lexon: "... duke u bërë thirrje të
17 gjithë shqiptarëve që të luftojnë për lirinë e Luginës së
18 Preshevës në Serbi".

19 E shihni këtë?

20 PË. Po. Dhe qëndroj pranë komenteve të mia bazuar në atë që
21 kemi dëgjuar se ata duhet të qëndrojnë aty me çdo kusht, nuk
22 duhet të vinin në Kosovë, të ktheheshin në Kosovë dhe duhet të
23 qëndronin aty. Siç e thashë, menduam që kjo nuk ishte e vendit
24 dhe mund të ngjiste shqetësime sa i përket Rezolutës së Kombeve
25 të Bashkuara 1244 dhe kjo është ajo që kam shënuar në atë

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 129

1 kohë.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim
3 transkriptin e fjalimit të z. Thaçi, i cili tani ka numrin e
4 provës materiale.

5 Znj. Sekretare, ndoshta e keni ju, mund të ma kujtoni
6 numrin e provës materiale që ju dha fjalimit.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për procesverbal, bëhet
8 fjalë për provën materiale 1D0176.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
10 faqen e fundit.

11 PY. Ku në këtë faqe apo në këtë fjalim, z. Russell, ku ju
12 thoni që z. Hashim Thaçi i ka bërë thirrje gjithë shqiptarëve
13 që të luftojnë për liri në atë luginë?

14 PË. Aty thuhet "Ata kanë të drejtë të jetojnë aty, sepse janë
15 autoktonë dhe do të jetojnë atje. Ne nuk do t'i lejojmë ata që
16 të ikin nga atje që ne t'i pranojmë këtu. Ne duhet t'i
17 ndihmojmë ata që të jetojnë aty ku janë dhe ata do të jetojnë
18 aty ku janë".

19 PY. Nuk ka asnjë referencë për të luftuar këtu, s'përmendet?

20 PË. Në qoftë se ju kujtohet deklarata ku thuhet që "ne jemi
21 gati të bëjmë gjithçka që duhet të bëjmë" dhe kjo ka ngritur
22 shqetësime. Dhe në kontekst, ne kemi kapur disa elementë të
23 UÇK-së që ishin nga Lugina e Preshevës.

24 PY. Unë po përpiqem t'ju jap elementë për të kuptuar se pse
25 kam shënuar këto gjëra.

1 PY. Ju i keni shënuar këto gjëra sepse keni dëgjuar Hashim
2 Thaçi t'i ketë thënë atë ditë, apo jo?

3 PË. Po, është e saktë.

4 PY. Por ai nuk i ka thënë këto gjëra atë ditë?

5 PË. Ju po merrni fjalë të hequra nga konteksti, por në qoftë
6 se ju merrni të liruar "pa serbë", "pa Serbi", në qoftë se e
7 shikoni aty ku flitet që "ata duhet të jetojnë". Ka elementë
8 që janë aty të mjaftueshëm.

9 PY. Tani po shikoj dhe një herë. Çfarë është gabim ku të
10 thuhet që dikush, njerëzit kanë të drejtë të jetojnë në
11 shtëpitë e tyre, "duhet t'i ndihmojmë ata"?

12 PË. Mund të imagjinoni për një çast se ne kishim parë
13 jashtëzakonisht shumë dhunë çdo ditë dhe e imagjinoni që
14 kishim kapur, gjetur dokumente njerëz që ishin nga Lugina e
15 Preshevës që ishin të paligjshëm, ia kishim dhënë
16 administratës së UNMIK-ut, dorëzuar ata dhe pastaj ishin
17 dërguar mbrapsht në shtëpi, këto gjëra ishin kanë zgjuar
18 interes tek ne të menjëhershëm. Dhe kur dëgjoheshin njerëz që
19 bënin komente të tilla, "ne që, pra, ishin gati të bëjnë çdo
20 gjë që duhej të bëhej". Ne kishim patur këtë lloj aktiviteti
21 ushtarak të mëparshëm rreth fundit apo më 9 gusht dhe ne
22 kishim prova për një gjë të tillë. Pra, këto ishin gjëra që na
23 kishin alarmuar kur ne i dëgjonim ato.

24 PY. Ku në ato fjalë aty dhe po e shoh aty, thuhet që "do të
25 bëjmë gjithçka që është e nevojshme"? Unë nuk e shoh atë.

1 PË. Nuk jam -- jam i sigurtë që mund të gjej aty.

2 "... ne do t'i përgjigjemi situatave të rrezikshme".

3 Dhe:

4 "Ne nuk do t'i lejojmë ata që të largohen prej atje dhe
5 të vijnë këtu. Duhet t'i ndihmojmë ata që të jetojnë aty dhe
6 ata do të jetojnë aty."

7 Dhe duke u përgjigjur situatave të rrezikshme që mund të
8 ndodhin më vonë, pra, në qoftë se i dëgjoj të gjitha këto
9 gjëra, duke patur parasysh edhe trajnimet dokumentet e
10 sekuestruara, trajnimet lidhur me Luginën e Preshevës, janë
11 gjëra që na alarmuan menjëherë.

12 PY. Faleminderit. Do të kaloj në një temë tjetër. Kam vetëm
13 dy çështje për të trajtuar ndoshta mund ta bëjmë përpara
14 pushimit.

15 Dhe, në fakt, a jeni në dijeni që mund të ketë -- mund të
16 ndodhi pas kohës tuaj, pra, kjo mund të jetë edhe përgjigje se
17 në fakt Hashim Thaçi ka luajtur një rol kyç në ndalimin e
18 konfliktit në Luginën e Preshevës, parandalimin e këtij
19 konflikti dhe ka punuar së bashku me KFOR-in dhe përfaqësuesit
20 amerikanë?

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund t'jua tregoj
22 dy artikuj që e konfirmojnë këtë gjë. I pari është nga *New*
23 *York Times* dhe referenca për të është DHT04062 deri në
24 DHT04064. Ky version ka nënvijëzime me ngjyra. U përpoqëm ta
25 zgjidhim këtë problem por nuk arritëm, s'besoj se ka ndonjë

1 ndikim. U përpoqëm që të gjenim një kopje të panëvizuar gjatë
2 pushimit të drekës por nuk gjetëm.

3 Ne për nevojat tona u desh që të nënvizionim pjesë të
4 këtij dokumenti. Gjatë pushimit të drekës biseduam me
5 Prokurorinë dhe nuk kundërshtuan faktin që ne të dorëzonim dhe
6 të përdornim versionin e nënvizuar.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në goftë se
8 s'ka kundërshtime.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
11 vazhdoni.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dokumenti i parë pra.
13 Faleminderit.

14 PY. Ky është një artikull i *New York Times*, 11 mars 2000, në
15 thelb thuhet këtu që Hashim Thaçi dhe gjeneral Clark, pra,
16 thotë që Hashim Thaçi ka qenë krah për krah me gjeneralin
17 Clark.

18 Dhe për të shkojmë në faqen 2, në gazetë thuhet, pak më
19 poshtë ju lutem. Komenti nga James Rubin.

20 "Z. Thaçi dhe udhëheqës të MPK-së strukturës civile që ka
21 zëvendësuar Ushtrinë Çlirimtare, mesa duket po dëgjojnë dhe po
22 marrin masat e duhura në këtë intervistë, në një intervistë
23 këtë javë pas një takimi në Kosovë me gjeneralin Clark, z.
24 Thaçi tha qartazi se Lugina e Preshevës ndonëse dikur ka qenë
25 pjesë e Kosovë nuk ishte shqetësimi i tij".

1 Dhe ka thënë se shqetësimi i tij ishte Kosova.

2 Pra, a e dini ju që ky ka qenë qëndrimi i z. Thaçi?

3 PË. Nuk e dija që ka qenë ky qëndrimi i tij në mars. Por unë
4 isha i qartë për qëndrimin që kishte ai në tetor, dhe ky
5 qëndrim ishte i ndryshëm.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet. Njësoj
8 si dhe materialet e tjera ne nuk kemi asnjë kundërshtim që të
9 pranohen këto dokumente, por njësoj si dhe në rastet e
10 mëparshme, ky dëshmitar thjesht ka shprehur sërish qëndrimet e
11 tij dhe nuk ka bërë asgjë më shumë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Materiali DHT04062-DHT04064 pranohet.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
15 numrin e dokumentit 1D00181. Klasifikimi është publik.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe dokumenti i fundit që
17 dëshiroj t'ju tregoj, i nderuar zotni, është dokumenti që
18 mban numrin DHT04065 deri në DHT04066. Është një artikull
19 kësaj here nga *BBC*-ja.

20 PY. Më 24 mars të vitit 2000, në këtë artikull, ju lutem,
21 shihni paragrafin e parë thotë:

22 "Udhëheqësit e një grupi rebelësh shqiptarë në Serbinë
23 jugore kanë kërkuar që të gjejnë një zgjidhje politike dhe jo
24 ushtarake për problemet që kanë në regjionin e tyre."

25 Dhe kjo është thënë nga Januz Musliu. Shkojmë në faqen

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 134

1 tjetër të këtij dokumenti, do të shihni, që z. Musliu e ka
2 bërë këtë deklaratë pas bisedimeve me Hashim Thaçin, të
3 pranishëm kanë qenë edhe diplomatët e amerikanë në dhomën
4 ngjitur dhe kjo ka ndodhur në Gjilan.

5 A e keni parë ju këtë artikull dhe a e keni ditur ju që
6 Hashim Thaçi bashkëpunonte me amerikanët për të krijuar paqe?
7 PË. Unë di që në bastisjen që bëmë në fjetore, gjetëm prova
8 që persona nga Presheva po stërviteshin atje.

9 PY. Në rregull.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] A mund të kërkoj që të pranohet
11 ky dokument mbi të njëjtat baza?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
13 kundërshtime?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
16 DHT04065-DHT04066 pranohet.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
18 numrin e provës 1D000182. Klasifikimi është publik.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit. Unë nuk kam më
20 pyetje.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Tani do të bëjmë dhjetë minuta pushim.

23 Ju lutem largohuni nga salla e gjyqit. Dhe mos flisni me
24 askënd për dëshminë tuaj.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 135

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
3 orën 3.45.

4 --- Seanca ndërpritet në orën 15.35

5 --- Seanca rifillon në orën 15.46

6 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
7 silleni dëshmitarin në sallë.

8 Znj. Tavakoli, përfunduat?

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, unë përfundova.

10 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju?

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po. Ne kishim kërkuar gjysmë
12 ore dhe mendoj se kaq do na nevojitet.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni.

16 Do të vijojmë me kundërpjetjet. Tani e ka radhën Mbrojtja
17 e Veselit. Pyetjet për ju do t'i bëjë znj. O'Reilly.

18 Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly:

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Faleminderit.

20 PY. Mirëdita, z. Russell. Unë kam rreth gjysmë ore pyetje
21 por, për sa kohë u qëndrojmë fakteve dhe opinione dhe u
22 përgjigjemi pyetjeve.

23 PË. Do të bëj të pamundurën.

24 PY. Unë, në fakt, do të vazhdoj aty ku e la kolegja ime. Pra,
25 do të flas për luginën e Preshevës. Do të doja që të shfaqej

1 në ekran materiali me numër IT-50-87 [Sipas përkthimit] që
2 është një hartë e luginës së Preshevës.

3 Dokumenti ka numrin 6D000209, numrin e provës së pranuar.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Numri i materialit atëherë

6 është numri IT-05-87 është nga gjykimi i Milutinovic.

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim]

9 PY. Kjo është një hartë që në vija të përgjithshme tregon
10 zonën tuaj të veprimit në një 1999.

11 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në fakt, nuk është e plotë
12 sepse do të doja që të zvogëlohej më pak që të shihnim të
13 plotë luginën e Preshevës. Këtu.

14 PY. Kemi Preshevën në jug-lindje të Gjilanit, në anën -- më
15 falni, në anën lindore të Gjilanit. Këtu mund të shihni pak a
16 shumë Gjilanin në qendër, në krye të ekranit dhe disa zona të
17 tjera që janë relevante për dëshminë tuaj si, për shembull,
18 Malisheva, ku kishte UÇK-ja një objekt zyrtar. Pastaj kishte -
19 - kemi Prilepnicën.

20 PË. Po, kështu.

21 PY. Po Presheva në fakt këtu nuk është shumë e qartë.

22 PË. [Nuk ka përkthim].

23 PY. Po, po, nuk është e qartë sepse në fakt është në një kufi
24 të brendshëm me Serbinë. Tani kemi dëgjuar shumë persona --
25 nga personat që -- shumë persona që vinin e dilnin, duket

1 sikur kishte shumë persona -- na [E pakuptueshme] shumë
2 persona në Preshevë. Tani, a mund të na sqaroni çfarë ka qenë
3 kjo shifra 11,000 persona? Mendoni që është pak a shumë numri,
4 shifra e saktë për personat në Preshevë në atë kohë?

5 PË. Në fakt ne mbështeteshim shumë në raportet e IOM-it në
6 atë kohë. E dinim që kishte shumë syresh. Ne raportnim ata që
7 shihnim.

8 PY. Për çfarë i raportnit saktësisht?

9 PË. Pra, ne i thonim, njoftnim IOM-in se sa persona kishim
10 pritur ne.

11 PY. Pra, kishim 11,000 persona që kishin kaluar kufirin dhe
12 që u ishin dëmtuar të gjitha shtëpitë. Pra, ne mund të themi,
13 është e qartë që këta persona nuk vinin për pushime, apo jo?
14 Ju e dini shumë mirë që aty kryhej një diskriminim shumë i
15 madh në të gjithë rajonin?

16 PË. Po.

17 PY. Faleminderit. Tani të flasim për situatën pa një dislokim
18 të saktë, të plotë të UNMIK-ut për t'i mbështetur ata nga
19 pikëpamja policore?

20 PË. Nuk jam i sigurt a e kuptova pyetjen tuaj.

21 PY. Pra, po përpiqesha të thoja që UNMIK-u në fakt nuk ishte
22 dos -- nuk ishte dosli -- dislokuar tërësisht në shtator, apo
23 jo?

24 PË. Deri në atë moment, po, jo kështu ka qenë. Pra, në
25 bashkëpunim me policinë ushtarë ne përpiqeshim të trajtonim

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 138

1 situata konkrete që lidheshin me funksionet e policisë, apo
2 jo?

3 PY. Po. Megjithatë, ju po merreshit me situatat që në fakt
4 nuk ishin në përputhje me kompetencat që ju lejonte ju
5 Rezoluta, apo jo? Dhe ju e keni thënë këtë dhe paradite që
6 ishte shumë e rëndësishëm që të respektoheshin të gjitha ato
7 që ishin thënë në Rezolutë?

8 PË. Në fakt ne kishim kompetenca. Ne e kishim të drejtën që
9 të shkonim, siç qe rasti i Gjilanit, ne mund të shkonim atje
10 dhe kryenim funksionet e policisë.

11 PY. Në fakt, po. Por, duke qenë se nuk ishte bërë dislokimi i
12 plotë i UNMIK-ut, shkonit ju atje për të mbushur një hendek,
13 nëse mund t'i referohemi në këtë formë, dhe ju keni qenë në
14 një zonë ku pasur 11,000 persona të zhvendosur. Tani, këtu po
15 bëjmë matematikë. Këtu po bëjmë një llogari të thjeshtë tani.

16 Kolegu juaj ka thënë kështu, Mike Matthews, ka thënë që
17 "Ajo që bënim ne ishte përtej asaj që mund të bënim ne
18 realisht në atë kohë". A keni ndonjë arsye për ta kontestuar
19 atë që ka thënë ai?

20 PË. Po flisni në kontekstin e funksioneve të policisë? Nëse
21 është kjo, duhet të flisni me Mike Matthews. Ai mund të thotë
22 a kishim apo nuk kishim forca të mjaftueshme për të ndaluar
23 dhunën. Sipas meje, ne i kishim këto forca.

24 PY. Po meqë i kishit këto forca, mendonit se ju ia dolët me
25 sukses ta parandalonit dhunën?

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 139

1 PË. Po ama ja ku është Kosova sot. Kështu, kemi pasur një
2 fillim të mirë.

3 PY. Të flasim për dy raste konkrete gjatë bastisjeve ku nuk
4 keni qenë domosdoshmërisht mbase ju i pranishëm. Fillimisht
5 flasim për bastisjen që u bë në ndërtesën e logjistikës në
6 fillim të gusht. Me datë saktë nuk e themi dot se kur ka
7 ndodhur. Besojmë se ka qenë -- ka ndodhur në fillim të
8 gushtit.

9 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të shohim provën materiale
10 P1512. Ju lutem ta vendosni në ekran.

11 Faleminderit. Më është kërkuar nga përkthyesit të
12 ngadalësoj sepse nuk janë në gjendje të më ndjekim. Do të
13 përpiqem të mos flas kaq shpejt.

14 PY. Dokumenti lidhet me bastisjen që është kryer në ndërtesën
15 e logjistikës. Mesa shoh unë këtu nuk ka autorë ky dokument.
16 Dëshmitar, si e kuptoni ju? Sipas jush, kush e ka përpiluar
17 këtë dokument? Dhe nëse dëshironi mund të shohim edhe faqen
18 tjetër.

19 PË. Po, do të ishte e dobishme. Faleminderit. Mbase seksioni
20 i policisë ushtarake apo i shërbimit informativ. Sepse ata
21 përpunonin këto informacione në kompjuter.

22 PY. Ju në deklaratën tuaj thoni që e keni lexuar raportin nga
23 Per Rotier [Sipas përkthimit]. A e shqiptova siç duhet?

24 PË. Po, ai ka qenë shefi i shërbimit informativ për Task
25 Forcën.

- 1 PY. Për këtë po thoni ju kur ju thoni kaq më kujtohet?
- 2 PË. Nuk e kuptova pyetjen tuaj.
- 3 PY. Ju personalisht nuk keni qenë kur është kryer bastisja?
- 4 PË. Duhet të kuptoni diçka që kur bëjmë bastisje, ne këtë e
5 bëjmë për të pasur -- për të pasur një ide më të qartë, për të
6 sekuestruar dokumentacione që mund të jenë të dobishme dhe të
7 përcaktojmë çfarë është e rëndësishme, çfarë nuk është e
8 rëndësishme. Materialet duhet të kenë vula, nënshkrime.
- 9 PY. Dëshmitar, ju lutem, pyetja ime është kjo: A keni qenë ju
10 i pranishëm kur është bërë bastisja?
- 11 PË. Cila bastisje?
- 12 PY. Bastisja pra ku keni përgatitur dhe këtë listën e
13 materialeve që pretendoni se keni gjetur atje.
- 14 PË. Bastisja ka nisur nga policia ushtarake. Ne u njoftuam që
15 do të kryhej dhe shkuam atje me Task Forcën, me forcat e Task
16 Forcës 126, dhe unë do të kisha qenë i pranishëm.
- 17 PY. Dëshmitar, në intervistën tuaj, që është intervista e
18 dytë, ju keni thënë:
- 19 "Nuk kam qenë i pranishëm gjatë bastisjes."
- 20 Por keni thënë që:
- 21 "Më kujtohet në këtë bastisje sipas raporteve që kam
22 marrë për këtë bastisje janë sekuestruar kopje fizike të disa
23 dokumenteve."
- 24 PË. Edhe një herë, bastisjen e nisi Mike Matthews. Ne kemi
25 shkuar në vendngjarje pasi kishte përfunduar situata.

1 PY. Pra, në kundërshtim me atë -- me atë që keni thënë me 5
2 maj 2022, ju paskeni qenë i pranishëm gjatë bastisjes.

3 PË. Po nuk kam qenë i pranishëm fizikisht kur u krye
4 bastisja.

5 PY. Dëshmitar, atëhere kur keni qenë i pranishëm, në
6 ç'moment?

7 PË. Është në fakt termi që do të përdorja unë vendngjarja.
8 Tamam termi vendngjarje. Në momentin që ishte mbrojtur dhe
9 rrethuar vendngjarja shkuam për të parë se çfarë kishte
10 ndodhur.

11 PY. Sidoqoftë, thelbi është ky, nuk ka rëndësi a keni qenë në
12 fillim apo në fund të ditës në këtë vend, apo pasi ishin
13 sekuestruar materiale. Ju keni thënë që nuk mund të jeni i
14 sigurt, nuk ju kujtohet nëse keni parë lista fizike, kopje
15 fizike, pra, të listave, apo në kompjuter apo kanë ekzistuar
16 këto lista. Këtë keni thënë ju në intervistën e 2022.

17 PË. I qëndroj deklaratës që kam dhënë. Asimilimi dhe
18 raportimi i asaj që kemi bërë është mbështetur në policinë
19 tonë ushtarake dhe në sektorin e shërbimit informativ.

20 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Shkojmë dhe shohim edhe një
21 herë në krye këtë dokument.

22 PY. E kuptoj që këtë nuk e keni shkruar ju, nuk e keni
23 përpiluar ju. Po ka një mospërputhje këtu dhe do të doja të na
24 ndihmoje, nëse mundeni. Thotë:

25 "Në pikën 3, data e informacionit, korrik 1999."

1 Shkojmë te "TEKSTI", pika 1. Këtu thotë:

2 "Gjatë një bastisje të KFOR-it në ndërtesën
3 administrative të UÇK-së në Gjilan, më 6 gusht janë
4 sekuestruar kompjuterë."

5 Shkojmë tek faqja tjetër. Përsëri këtu përmendet një
6 dokument në datën 5 korrik që është sekuestruar edhe thotë
7 dokumenti i datës 5 korrik është sekuestruar më 6 korrik, që
8 mendohet që është kjo lista.

9 PË. Më falni, më falni, bëhet fjalën për të njëjtën bastisje?
10 Apo është një bastisje tjetër?

11 PY. Po shpresoja që ju të ma sqaronit mua këtë.

12 PË. Unë mund t'ju them që Task Forca Falcon nuk ka pasur
13 kontroll operacional nga Njësia e Marinës 26, me numrin 26. I
14 gjithë transferimi i kompetencave është -- ka përfunduar më 10
15 korrik. Pra, nga data 26 e në vijim ata nuk kishin më asnjë
16 lloj kompletim -- kompetencë.

17 PY. Domethënë, këto data nuk ju duken të sakta, apo jo?

18 PË. Po, nuk më duken të sakta. Para 10 korrikut ka qenë
19 ndryshe.

20 PY. Domethënë, mund të jetë edhe një gabim sipas jush?

21 PË. Nuk ka mundësi të kemi bërë ne bastisje me Task Forcën
22 tonë para 10 korrikut. Pra, mund të jetë përshkrimi i saktë,
23 por data, jo.

24 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Më jepni një moment. Është një
25 dokument tjetër që është i rëndësishëm për ne dhe do të ishte

1 mirë që të shihnim. Është një pjesë e ditarit tuaj.

2 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Është ditari që i keni dhënë
3 ZPS-së. Besoj se mban numrin P1519. Dhe na nevojitet 105825.
4 Uroj ta kem të saktë këtë referencë.

5 PY. Shohim pjesën e dytë të këtij shënimi. Fillon:

6 "Ndër materialet u gjetën" --

7 PË. Për cilën datë e keni fjalën?

8 PY. Në 4 gusht. Kemi një datë tjetër këtu. Po nuk po e
9 trajtoj tani këtë.

10 "Ndër materialet që u gjetën kishte dhe pamflete kundër
11 KFOR-it, lista prostitucioni, shënime për UNMIK-un dhe KFOR-
12 in, dokumenta policore të paligjshme, foto të veprave të artit
13 dhe monumenteve Ortodokse serbe. Sekuestruam kompjutera dhe
14 dokumente të tjera, duhet të përktheheshin."

15 Këtu nuk përmenden listat.

16 PË. Mesa më kujtohet mua, për shkak të natyrës dhe sasisë së
17 dokumentacionit që gjetëm, ishte e rëndësishme që t'i merrnim
18 këto dokumente, po kjo kërkoi disa ditë si proces.

19 PY. Ju e keni theksuar shumë që raportimi i asaj kohe duhet
20 të ishte shumë i saktë. Prandaj unë po iu referohem dhe do të
21 doja ta trajtoja pak këtë aspekt.

22 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Do ju lutesha të shihnim edhe
23 një herë provën materiale P1512, është një pjesë tjetër që
24 doja ta shihnim bashkë. Dhe ju kërkoi ndjesë që po ju rishfaq
25 një dokument që e pamë pak më herët. Shkojmë në faqen 2 të

1 dokumentit.

2 PY. Po shoh paralajmërimin në fund, ku thohet:

3 "Ky është një raport informativ, që nuk ka marrë
4 vlerësimin përfundimtar nga shërbimi informativ."

5 Edhe madje më lart thotë:

6 "Ky është një raport paraprak, raportet e mëtutjeshme do
7 të përgatiten në momentin që të merren informacione shtesë."

8 Ne nuk i kemi raportet e tjera. Nuk kemi parë raporte të
9 tjera. Besoj që as ju s'keni raporte të tjera?

10 PË. Në lidhje me çfarë?

11 PY. Po në lidhje me këtë veprimtari që është mbajtur më 6
12 gusht, pra. E kemi fjalën për bastisjen që është bërë në
13 ndërtesën e logjistikës.

14 PY. Me përjashtim të materialeve që kemi gjetur, qofshin këto
15 lista, pamflete, mund t'ju them që ky paralajmërimi këtu ishte
16 për të thënë që ky raport fillestar nuk e bën të paligjshëm në
17 fakt, apo jolegjitim raportin. Por në fakt thotë që ky është
18 raporti fillestar që kemi ne. Po nuk është i parregullt, i
19 pasaktë.

20 PY. Në rregull. Do të doja ta dija këtë përgjigje sepse kjo
21 është e rëndësishme për peshën që do t'i jepet këtij
22 dokumenti.

23 Kalojmë tani në fjetoren -- në bastisjen e fjetores më 9
24 gusht. Mesa kuptoj unë, atë ditë ju keni pasur një ditë shumë
25 të gjatë. Keni filluar që në 9.30 të mëngjesit dhe keni punuar

1 deri në 10.00 të darkës, apo jo?

2 PË. Ka qenë një ditë e gjatë, shumë aktive.

3 PY. Ta përmbledhim. Ju keni hyrë -- keni -- jeni futur në një
4 ndërtesë të asaj që mendohej që ishte ndërtesë e UÇK-së, për
5 shkak të flamujve që patë që valëviteshin jashtë. Gjetët disa
6 armë, por thatë që ata ishin të zgjuar sepse nuk gjetët ndonjë
7 artileri të rëndë, dhe përveç disa pistoleve -- pistoletave
8 dhe pushkave, nuk keni gjetur gjë tjetër.

9 PË. Kur them artileri e rëndë, e kisha fjalën më shumë për
10 mitralozë, këtu, automatikë.

11 PY. Pastaj, në fund të ditës keni gjetur një dhomë ku kishte
12 gjak në dysHEME, por asnjë person.

13 PË. Ju lutem, përsëriteni edhe një herë pjesën e parë të
14 pyetjes.

15 PY. Keni gjetur një dhomë që e keni përshkruar si dhomë
16 torturash, që ishte një dhomë bosh, por kishte gjak në
17 dysHEME.

18 PY. Na kishin thënë më përpara që mund të ekzistonte një
19 ambient i tillë. I kishim përgatitur shërbimin e vrojtimit
20 paraprakisht. Kjo ishte bazuar në disa raporte që kishim marrë
21 nga Mark Matthews dhe policia ushtarake. Bazuar në këtë
22 informacion ne filluam -- ne bëmë një vëzhgim, filluam të
23 bënim një vëzhgim të këtij ambienti, dhe në fund vendosëm të
24 bënim një bastisje me shumë forca.

25 PË. Në rregull. Pra, gjetët një dhomë bosh, kishte gjak në

1 dysHEME. Nuk e dini as kujt i përkiste ky gjak, as sa kohë
2 kishte ky gjak në dysHEME. Dhe ju thoni që ka ekzistuar dhe
3 një viktimë e pretenduar, por emrin nuk ia dimë.

4 PË. Nuk e dija unë, po kompania e policisë ushtarake e dinte
5 dhe po e mbronte identitetin e saj.

6 PY. Faleminderit.

7 PË. Unë si veteran luftërash në tri vende, dhe kam marrë
8 pjesë në luftime të ndryshme të egra, unë e di dallimin mes
9 një gjaku të vjetër dhe gjaku që është derdhur kohët e fundit.

10 PY. Ju e dini që serbët kishin rreth dy muaj që ishin
11 larguar. Janë larguar pak a shumë rreth datës 12 deri në 14
12 qershor nga Gjilani, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Më jepni një çast, ju lutem.

15 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Është një dokument që do të
16 doja ta shihnim. Nuk jam e sigurt a ka marrë numrin e provës
17 materiale, por mund të jap ERN-në që mban numrin 106157 [Sipas
18 përkthimit]. Është në pjesën tonë të dokumenteve, në
19 dokumentacionin tonë. Sapo më thanë që nuk ka numër të provës
20 materiale.

21 PY. Ndërkohë që presim dokumentin, në intervistën e dytë ju
22 keni thënë, Pjesa 2, faqja 24, që keni gjetur mjete stërvitore
23 në shkollë. Edhe titulli i dokumentit që do të shohim ne në
24 ekran e ka titullin "Pajisjet e Stërvitjes apo të Trajnimit".
25 Paketa trajnimi, në fakt, për përdorimin e eksplozivëve.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na jepni
2 numrin e plotë të dokumentit që të gjejmë dhe faqen përkatëse
3 në të?

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po. Është dokumenti me numër
5 105816. Është faqja e parë, është deri në 106095. Dhe në këtë
6 varg dokumentesh është faqja 106057. E zmadhojmë pak tekstin e
7 kësaj fletëpalosjes. Në pamje të parë duket sikur është një
8 fletëpalosje.

9 PY. Këto janë materialet që keni përmendur në intervistën
10 tuaj?

11 PË. Jo nuk janë të gjitha këtu.

12 PY. E shihni që këtu në fakt teksti duket të jetë në
13 serbisht, dhe as në shqip as në anglisht.

14 PË. Po s'është për t'u befasuar. Shumica e manualëve të
15 armatës jugosllave ishin në serbo-kroatisht.

16 PY. Faleminderit.

17 Të flasim për bastisjen shkurtimisht. Ju thatë që nisi
18 mirë, bëtë të gjitha fotografitë dhe orën e parë arritët që të
19 largonit të gjithë nga godina, kështu?

20 PË. Po. Ky ishte objektivi, të bënim sa më shumë fotografi
21 dhe të ndalonim vetëm ata që mund të identifikoheshin më pas.

22 PY. Dhe më pas ndodhi një pengesë e madhe, ndodhi pak një
23 situatë kaotike edhe zgjati gjithë ditën bastisja, apo jo?

24 Pikësëpari, Ahmet Isufi nuk ishte atje, apo jo?

25 PË. Ai nuk duhet, në fakt, të ishte atje.

1 PY. Por ju i kërkuat atij që të vinte më vonë, apo jo?

2 PË. Po. Sepse ne do të donim që ai të identifikohet për disa
3 nga gjërat që kishim zbuluar. Dëshironi -- më falni, që ai të
4 identifikonte disa nga gjërat që ne kishim zbuluar.

5 PY. Në rregull. Siç thatë në fillim të ditës së sot, kishte
6 disa të dhëna që mund të kishte rezistencë nga ana e Isufit,
7 për shembull, kjo ka ardhur nga Adrian Muhamet [Sipas
8 përkthimit] që ka bërë komente të tilla dhe ka thënë "Ai nuk
9 është komandanti im se jam unë në drejtim këtu. Këta nuk janë
10 -- këta janë ushtarët e mi". A ju kujtohet kjo?

11 PË. Më kujtohet që në fakt ishin disa persona që bënë
12 rezistencë. Ardian Mehmeti, Adyl Ramadani [Sipas përkthimit]
13 më duket. Ata mbanin karta të JIC-së.

14 PY. Po.

15 PË. Dhe kështu ishim në gjendje në fakt që të merrnim vesh
16 emrat e tyre, përveç këtyre kartave -- për shkak të këtyre
17 bexheve që mbanin, pra.

18 PË. Kur patëm diskutime me -- gjatë -- patëm diskutim me
19 Isufin edhe tensioni filloi të shtohet më shumë gjatë ditës.

20 PY. Në fakt, ju kishit -- nuk ka ndonjë paqartësi këtu,
21 Adrian Mehmeti ka thënë "Këta janë personat e mi", dhe
22 Avdyllah Ramadani që e përshkruani në ditarin tuaj si
23 Abdylaman Rrahman Ramadani këtë e përshkruani si udhëheqësin
24 kryesor atje, apo jo?

25 PË. Mesa më kujtohet shumë nga diskutimet ata po i bënë mes

1 vedi. Ata po përpiqeshin t'ia linin të gjithë përgjegjësinë
2 Isufit. Mua m'i përkthenin, m'i përkthenin këto që po
3 thuheshin atje.

4 PY. Po çfarë po thuhej?

5 PË. Po kishte disa deklaratata që unë i kam dhënë më përpara
6 dhe nuk do të doja të tregohesha vulgar në sallën e gjyqit.

7 PY. Për çfarë do ishit vulgar, për mua është okej.

8 PË. Po mund t'i gjeni te deklaratat këto që janë thanë.

9 PY. Unë s'i kam të qarta për çfarë po flisni.

10 PY. Po ato që ka thënë Mehmeti për Isufin. Për këto bëhet
11 fjalë.

12 PY. Në intervistën e majit për ZPS-në më 5 maj, pra, 2022, e
13 keni përshkruar Shaqir Shaqirin si personin e parë në hierarki
14 që do të thotë që ka qenë komandanti.

15 PË. Ne nuk konsideronim në fakt ata komandantë sepse nuk --
16 ne kishim kuptuar -- s'e kishim kuptuar të qartë organizimin e
17 tyre dhe si e kishin kuptuar ne, Isufi ishte komandanti dhe
18 Fatmiri ka qenë përgjegjës për një pikë grumbullimi në
19 Malishevë.

20 Po ne e dimë që ka qenë një person në Novo Brd që ishte
21 përgjegjës për një ambient tjetër që ne e -- po ashtu e
22 bastisëm dhe e mbyllëm.

23 Sa i takon të rinjve që ishin atje, nuk e kishim të qartë
24 se çfarë strukture kishin ata. Të paktën atje më 9 gusht.

25 PY. Mjafton. Faleminderit, Dëshmitar.

1 PY. Po ashtu keni përmendur se disa prej anëtarëve të UÇK-së
2 ose disa prej anëtarëve të pretenduar të UÇK-së ishin nga
3 lugina e Preshevës. Kemi diskutuar gjithashtu se si Ahmet
4 Isufi dhe UÇK-ja, ata donin që Ardian [Sipas përkthimit]
5 Mehmeti të mos kishte kartën e vet. Besoj që e dini këtë gjë,
6 apo jo?

7 PË. Po, më kujtohet kjo lidhje, domethënë, më kujtohet lidhja
8 ndërmjet luginës së Preshevës dhe këtyre personave ose
9 individëve. Nuk e di se cili prej tyre ishin prej Preshevës.

10 Nuk e di në qoftë se ka qenë aty ndonjëri prej tyre,
11 megjithatë është raportuar që kanë qenë aty dhe kishin
12 gjithashtu edhe elementin Kumanova të UÇK-së që ishte i
13 pranishëm. Ai -- në fakt kam marrë edhe flamurin i cili është
14 diku në -- e treguar, e dëshmuar sot.

15 PY. Megjithatë, a ju kujtohet që kanë qenë edhe disa persona
16 të pranishëm atë ditë për një ndeshje futbolli?

17 PË. Kjo u zhvillua më vonë.

18 PY. Nuk është se e keni pasur -- nuk keni pasur dijeni, nuk e
19 keni ditur që do kishte një ndeshje më pas, apo jo?

20 PË. Jo, ne nuk ishim të informuar që atë mbrëmje do të kishte
21 një ndeshje futbolli. Në qoftë se nuk gabohem për një ndeshje
22 futbolli që ka ndodhur diku nga pasditja, orët e pasdites.

23 PY. Arsyeja që pse nuk prisnit që të ishit për një kohë të
24 gjatë atje ishte që po prisnit që të merrnit urdhra për sa i
25 takon asaj çfarë donit të bënit prej eprorëve tuaj.

1 PË. Jo, ne e dinim se çfarë po bënim, po përpiqeshim që të
2 merrnim leje.

3 PË. Sepse nuk kishin automjete të mjaftueshme?

4 PË. Jo, jo, nuk ishte kjo arsyeja, por u vonuam sepse donim
5 që të zbulonim se çfarë kishte ndodhur sepse Task Forca Falcon
6 na kërkoi që të qëndronim atje dhe të merrnim vesh më tepër se
7 çfarë po ndodhte nga ana e udhëheqjes së UÇK-së.

8 PY. Po, sepse situata ishte e cenueshme dhe ishte -- kishte
9 shumë njerëz të grumbulluar dhe ju nuk është se kishit marrë
10 informacion sa i takon këtij aktiviteti më përpara?

11 PË. Bëhej fjalë për një ndeshje futbolli. Nuk kishim dijeni
12 të kësaj ndeshje futbolli.

13 PY. Në rregull. Faleminderit. Tani kam edhe disa tema të
14 tjera që dua t'i kalojmë së bashku.

15 Tema ose pika e parë ka të bëjë me djegien e shtëpisë, e
16 shtëpive që po zhvilloheshin ose që po ndodhte në zonë.

17 Kolegia ime bisedoi me juve pak më herët sa i takon masës së
18 shkatërrimit të shtëpive të shqiptarëve. Megjithatë, në
19 momentin që ju keni shkuar dhe keni qenë kryesisht të
20 shqetësuar djegien e shtëpive serbe, apo jo?

21 PË. Jo, jo, kjo nuk është e drejtë. Ne ishim të shqetësuar
22 për djegien e çdo shtëpie, të shtëpive të çdokujt.

23 PY. Në rregull. Dëshmitar, megjithatë ajo çfarë keni thënë
24 juve është që besonit se bëhej fjalë për djegien e shtëpive
25 serbe.

1 PË. Nuk kemi të bëjmë fare, nuk është e rëndësishme fare
2 etniciteti, fare këtu. Nuk ka bëjë. Thjesht ne po flasim për
3 vende të caktuara.

4 PY. Në rregull. Kam përshtypjen që ka një keqkuptim, se ne
5 kemi dëgjuar dëshmi këtu përpara këtij Trupi Gjykues që serbët
6 ndonjëherë digjnin shtëpitë e tyre për të parandaluar masat të
7 mëtejshme.

8 PË. Nuk e di këtë gjë. Megjithatë, policia ushtarake kishte
9 cituar që, mbështetur në të gjitha hetimet deri në shtator,
10 mesatarisht 82 për qind të dhunës ishte bërë nga shqiptarët
11 mbi serbët. Dhe duhet të dini se në atë kohë BSHK Lindje ishte
12 zona me popullsinë serbe më të dendur.

13 PY. Dëshmitar, më duhet të të ndërpres këtu. Përgjigjen --
14 pyetja ime -- pyetja ime kërkon një përgjigje që ka të bëjë me
15 informacionin që keni marrë apo jo për sa i takon djegies së
16 shtëpive nga serbët.

17 PË. Jo, njerëzit nuk djegin shtëpitë e tyre.

18 PY. Po unë po ju them që kemi informacion që kjo gjë ka
19 ndodhur.

20 PË. Ne nuk është se kemi pasur këtë informacion në sektorin
21 tonë. Ndoshta mund ta kenë pasur gjermanët, por jo ne.

22 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë që të
23 paraqesë në ekran një letër që e keni shkruar ju. Është
24 dokumenti 105816, faqja që dua të transmetohet është P105840.
25 Të kalojmë pak më poshtë në faqe. Ju kërkoj ndjesë. E thashë

1 referencën gabimisht. Faqja që kërkoj që të paraqitet në ekran
2 përfundon me 849. Të kalojmë tek fundi i paragrafit të dytë.

3 PY. Thuhet që:

4 "Për -- edhe pse unë kam një ndjenjë për sa i takon
5 shqiptarëve për shkak të akteve të tmerrshme të dhunës që kanë
6 kryer, gjithsesi kam keqardhje për njerëzit që janë të
7 pafajshëm ..."

8 Më tej vazhdohet si më poshtë:

9 "Ata ishin shtypës me siguri dhe që janë pastruar
10 etnikisht."

11 Dëshmitar, besoj që ju e dini që në këtë kohë ka pasur
12 rreth 10,000 shqiptarë të Kosovës të cilët janë vrarë gjatë
13 operacioneve, në veçanti gjatë Operacionit Patkoi. A është e
14 saktë kjo?

15 PË. Po, jam në dijeni të kësaj. Është e vërtetuar që të dyja
16 palët kanë bërë gjëra të tmerrshme dhe kemi qenë aty për t'i
17 ndaluar këto gjëra të tmerrshme që të ndodhin.

18 PY. Dëshmitar, a jeni në dijeni të faktit që MUP-i ka qenë
19 pjesë e forcave të armatosura që kanë marrë pjesë në atë
20 konflikt, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. A keni dëgjuar për aktgjykimin në çështjen Djordjevic nga
23 TPNJ-ja?

24 PË. Thuajeni edhe një herë?

25 PY. Jo po pyesja në qoftë se keni dëgjuar gjykimin Djordjevic

Dëshmitari: Steven Russell (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. O'Reilly

Faqe 154

1 nga TPNJ-ja?

2 PË. Jo.

3 PY. Është një proces gjyqësor ku është vërtetuar që shefi i
4 MUP-it është -- ka qenë fajtor dhe është dënuar për krimet e
5 kryera kundër njerëzimit, kundër shqiptarëve të Kosovës,
6 përfshirë këtu dhe nga zona për të cilën po flasim, dhe për të
7 cilën keni qenë ju përgjegjës në Kosovë. Në paragrafin 1035
8 thuhet që 4,000 vetë janë deportuar nga Prilnica [Sipas
9 përkthimit] që ju keni thënë në fillim fare që ka qenë pjesë e
10 përgjegjësisë tuaj, pra zonës së përgjegjësisë ku keni punuar
11 ju. Ndërkohë më tej në atë aktgjykim, në vendimin për këtë
12 çështje gjyqësore është thënë në paragraf 1048 që nga 420
13 shtëpitë që janë djegur 120 janë djegur plotësisht në Zhegro.
14 A e keni dëgjuar këtë gjë ju, Dëshmitar?

15 PË. Unë e di që në Zhegro, në veçanti, domethënë, jam në
16 dijeni të shtëpive të djegura që kanë qenë kryesisht të
17 serbëve po ashtu dhe kisha është desakruar, po ashtu situata
18 ka qenë e vështirë aty. Domethënë, për këtë gjë jam në dijeni.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera.

20 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
21 znj. O'Reilly.

22 Z. Tully, keni pesë minuta në dispozicion. Sa kohë ju
23 duhet?

24 Z. TULLY: [Përkthim] Pesë minuta është pak si vështirë që
25 të përfundoj, i nderuar Kryegjykatës. Megjithatë, duke pasur

1 parasysh që një prej dokumenteve është trajtuar dhe më përpara
2 në seancë përgatitore besoj që do të më duhet vetëm 20 minuta
3 për të bërë kundërpjetet për këtë dëshmitar.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 filloni nesër.

6 Dëshmitar, kemi përfunduar për sot. Do të fillojmë nesër
7 në orën 9.00 të mëngjesit. Besoj që do të përfundojmë nesër.
8 Megjithatë nuk ju premtoj dot se dot përfundojmë 100 për qind.

9 Ju lutem edhe një herë ju rikujtoj që nuk duhet të
10 diskutoni me askënd lidhur me përmbajtjen e dëshmisë që keni
11 dhënë sot. Faleminderit për dëshminë e dhënë sot, Dëshmitar.

12 DËSHMITARI: Faleminderit.

13 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që
14 të pranohet si provë fotografia që është dhënë nga ZPS-ja.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
17 për fotografinë 10657 [Sipas përkthimit].

18 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Jo, është dokumenti 106157.

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

20 Z. HALLING: [Përkthim] Për fotografinë me numër 106057
21 nuk kemi kundërshtim.

22 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 [Përkthim] Atëherë edhe një herë znj. O'Reilly, ju thatë
24 106057. E saktë është kjo, apo jo?

25 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, është e saktë.

1 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet si
2 provë.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
4 fotografia me numër ERN-je 106057 do të pranohet si provë
5 gjyqësore 2D000025 [Sipas përkthimit]. Do të klasifikohet si
6 konfidenciale.

7 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
8 [Përkthim] Në rregull. Ka ndonjë gjë përpara sesa të mbarojmë?

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sikurse u tha
10 dhe nga znj. Tavakoli, mua do të më duhet më pak sesa dy orë
11 për kundërpjetje. Po mundohem që të bëj shkurttime të tjera
12 duke u mbështetur tek pyetjet e bëra nga kolegët. Por, mendoj
13 që momentin do të më duhet një orë nesër. Ky është vlerësimi
14 që kam tani të paktën.

15 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
16 për informacionin e dhënë.

17 Do ta mbyllim këtu seancën sot dhe do të rishihemi sërish
18 në orën 9.00 të mëngjesit nesër.

19 --- Seanca mbyllet në orën 16.25

20

21

22

23

24

25